

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7120
E shkurt, 17 shkurt 2024
Çmimi 0.50

Rusia thotë se Navalny ka vdekur në burg



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA MARRË URIM PËR 16-VJETORIN E PAVARËSISË NGA PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, JOE BIDEN

FACE 4-5

BIDENI: E INKURAJOJMË KOSOVËN T'I PËRMBUSHË OBLIGIMET NGA DIALOGU ME SERBINË



Presidenti amerikan, Joe Biden, në letrën e urimit për 16-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dërguar presidentes Vjosa Osmani, ka konfirmuar se Kosova dhe ShBA-ja

ndajnë një miqësi dhe partneritet të qëndrueshëm të përforcuar nga vizioni i përbashkët për një rajon më paqësor, më të sigurt dhe më prosperues. Ai ka thënë se ShBA-ja

e inkurajon udhëheqjen e Kosovës t'i përmbushë të gjitha obligimet e dala nga dialogu me Serbinë, përfshirë të gjitha marrëveshjet e arritura përmes këtij procesi


OPINION

MOJ KOSOVË MOS THUJ MAROVA, SE SHOQPNIA HALA Æ GJALL'

Muhamet MAVRAJ



AKTUALE



NË PRANINË E MBI 200 MYSAFIRËVE, KONSULLATA E KOSOVËS NË NJU-JORK FESTON 16-VJETORIN E PAVARËSISË

SHSKUK-ja DHE ODA E MJEKËVE ARRIJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

KRASNIQI PRET NË TAKIM AMBASADORIN AMERIKAN: SHBA-ja, KRYEALATJA STRATEGJIKE E KOSOVËS

EKONOMI

GUVERNATORI I BQK-SË E PRET NË TAKIM AMBASADORIN FRANCEZ, E INFORMON PËR SISTEMIN FINANCIAR NË KOSOVË

SPORT



NORA E ARGJENDTË NË BAKU, DO TË JETË BARTËSE NË LOJËRAT OLIMPIKE

F. 10

PËRURORHET LIBRI 'SHTET I RI, BURRË SHTETI MODERN: HASHIM THAÇI, NJË BIOGRAFI'



HARADINAJ DHE LIMAJ VIZITOJNË PREKAZIN, PRITEN NË KULLË NGA RIFAT JASHARI



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia thotë se Navalny ka vdekur në burg



MOSKË, 16 SHKURT - Politikani opozitar rus Aleksei Navalny ka vdekur në burg, u tha në një deklaratë të lëshuar nga një departament lokal i Shërbimit Federal të Burgjeve. Raportimi për vdekjen e Navalnyt ka nxitur zemërim dhe dënim nga liderët botërorë që kanë thënë se kritiku i Kremlinit ka paguar “çmimin më të lartë” për kurajën e tij për të folur kundër udhëheqjes së shtetit.

Në deklaratën e Shërbimit Federal të Burgjeve u tha se Navalny u ndje keq pas ecjes më 16 shkurt dhe më pas humbi vetëdijen.

Një autoambulancë shkoi në tentim për ta trajtuar, por ai vdiq, u tha në deklaratë.

“Të gjitha masat për ta kthyer në jetë u ndërmorën, por ato nuk prodhuan rezultate pozitive.

Mjekët e autoambulancës e shpallën të vdekur të burgosurin. Shkaku i vdekjes është duke u përcaktuar”, u tha në deklaratën e Shërbimit rus, njoftim që nuk ka qenë e mundur të konfirmohet në mënyrë të pavarur.

Mediet e kontrolluara nga shteti rus, po ashtu, kanë cituar këtë deklaratë, duke raportuar se Navalny, 47 vjeç, ka vdekur.

Media shtetërore TASS citoi zëdhënësin e Kremlinit, Dmitry Peskov, të ketë thënë se presidenti rus, Vladimir Putin, është informuar për raportimet lidhur me vdekjen e Navalnyt dhe se ai nuk kishte informacione për shkakun e vdekjes së tij.

Ndërkaq, sekretarja për media e Navalnyt, Kira Yarmysh, shkroi në “X” se ekipi i kritikut të Kremlinit nuk ka konfirmim për vdekjen e

tij. “Shërbimi Federal i Burgjeve në qarkun Jamalo-Nenets po shpërndan lajme për vdekjen e Aleksei Navalnyt në burgun IK-3. Ne ende nuk kemi konfirmim për këtë lajm. Avokati i Navalnyt do të shkojë atje dhe sapo të kemi informacione do t’ju njoftojmë”, shkroi ajo.

Nënpresidentja amerikane Kamala Harris, gjatë një adresimi nga Konferenca e Munihut, fajësoi Rusinë për vdekjen e raportuar të Navalnyt. “Ky është një lajm i tmerrshëm, për të cilin po punojmë që ta konfirmojmë. Nëse konfirmohet, ky do të ishte një tregues i mëtejme i brutalitetit të Putinit. Çfarëdo rrëfimi që ata të kenë [Rusia], më lejoni të jemi të qartë: Rusia është përgjegjëse. Më vonë do të komentojmë më shumë për këtë

çështje”, tha ajo.

Ndërkaq, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se nëse raportimet janë të sakta, shpreh ngushëllime për gruan dhe familjen e tij. “Përtej kësaj, vdekja e tij në një burg rus dhe fiksimi dhe frika e një individit në pah dobësimin dhe kalbjen e sistemit që Putini ka ndërtuar. Rusia është përgjegjëse për këtë”, tha Blinkeni gjatë një deklarimi në Munihi.

Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, e cilësoi Navalny si një trim “që ia dedikoi jetën shpëtimit të nderit të Rusisë”. “Përderisa po presim informacione të mëtejme, le të jemi të qartë: kjo është përgjegjësi e Putinit”.

Kancelari gjerman Olaf Scholz tha se Navalny “ka paguar për

guximin e tij me jetën e tij”, ndërkaq ministri i Jashtëm i Francës, Stephane Sejourne, shkroi në X se “vdekja në burg [e kritikut të Kremlinit] na kujton të gjithëve realitetin e regjimit të Putinit”.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se Navalny bëri “sacrificën përfundimtare” në luftën e tij për “vlera të lirisë dhe demokracisë”.

Edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu “pikëllim” dhe shqetësim lidhur me raportimet për vdekjen e Navalnyt, duke kërkuar që të zbardhet gjithçka lidhur me këtë rast.

Më 14 shkurt autoritetet kishin njoftuar se Navalny ishte dërguar në izolim për të 27-n herë që kur ishte burgosur tri vjet më parë.

Senatorët e ShBA-së rrisin presionin ndaj Hungarisë

WASHINGTON, 16 SHKURT - Një delegacion i përbërë nga senatorët e dy partive në Kongresin amerikan do ta vizitojë Hungarinë të dielën, më 18 shkurt, në kohën kur po rritet presioni ndaj Budapestit për ta ratifikuar anëtarësimin e Suedisë në NATO kur Parlamenti i shtetit të kthehet nga pushimi dimëror.

Hungaria është shteti i vetëm i NATO-s që nuk ka ratifikuar aplikimin e Suedisë, një proces që kërkon mbështetjen e të gjitha shteteve anëtare. Kjo ka tensionuar raportet me Shtetet e Bashkuara dhe ka rritur



shqetësimet në mesin e aleatëve.

Suedia ka aplikuar për t’iu bashkuar NATO-s në maj të vitit 2022, e shtyrë nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës.

Kryeministri hungarez Viktor Orban, i cili ka raporte më të mira me Rusinë sesa me shtetet e Bashkimit Evropian dhe shumicën e anëtarëve të NATO-s, ka deklaruar se qeveria e tij mbështet anëtarësimin e Suedisë në aleancë, por në Parlament ende nuk është marrë një vendim për këtë.

Ambasada amerikane në Budapest njoftoi se senatorët do

të udhëtojnë për në Hungari “me mision të përqendruar në çështjet strategjike me të cilat përballen NATO-ja dhe Hungaria”.

Pranimi i Suedisë në NATO është një çështje që në mënyrë të drejtpërdrejtë prek sigurinë kombëtare të ShBA-së dhe, po ashtu, sigurinë e aleancës në tërësi, tha më herët gjatë këtij muaji ambasadori amerikan David Pressman.

Pranimi i Suedisë në NATO mund të ratifikohet kur Parlamenti hungarez ta rinisë punën në fund të shkurtit, ka thënë grupi parlamentar i partisë në pushtet, Fidesz.

Përrurohet libri “Shtet i ri, burrë shteti modern: Hashim Thaçi, një biografi”

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 16 shkurt - Në prag të 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, shtëpia botuese “Fan Noli” e Tiranës dhe Fondacioni “Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit”, promovuan dje në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës librin “Shtet i ri, burrë shteti modern: Hashim Thaçi, një biografi”, libër ky i shkruar nga dy autorë të njohur britanikë, Suzy Jagger dhe Roger Boyes, i përkthyer në gjuhën shqipe nga ish-kyediplomatja e Shqipërisë, Arta Dade. Pjesëmarrësit u bënë bashkë për ta

dhe djali i tij Endriti.

Kosova ka hyrë në vitin e katërt prej kur ish-presidenti Thaçi, figura kryesore e pavarësisë, po mbahet padrejtësisht në Hagë, të cilit nuk i është mundësuar madje as arresti shtëpiak, madje as bashkëluftëtarëve të tij. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, në fjalën e tij në këtë promovim, ka përhëndetur ish-presidentin Thaçi, si dhe bashkëluftëtarët e tij që, sipas tij, edhe sot e kësaj dite po zhvillojnë betejën e rëndësishme për mbrojtjen e pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit tonë. “Pa dyshim, të gjithë ju, gazetarë, publicistë, historianë, politikanë, miq, kolegë e familjarë të



dëshmuar dhe kujtuar kontributin e pashoq të ish-presidentit Hashim Thaçi në çlirimin, shtetkrijimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. Të pranishëm në përrurimin e librit ishin edhe bashkëshortja e Thaçit

presidentit Thaçi, dini mjaftueshëm për figurën, kontributin dhe rolin e pashoq që ai ka pasur në historinë e re të popullit dhe shtetit tonë. Vepra e presidentit Thaçi është nga ato që mbeten të



shënuara përgjithmonë dhe nuk mund të tejkalohen. Prandaj, më shumë sesa për librin dhe biografinë e tij, dëshiroj që përmes copëzave të rrëfimeve personale, të shkëputura nga mbi 15 vite të punës së afërt me të, të përpiqem të flas për një anë tjetër të tij - atë që e bën atë vërtet një burrë shteti të veçantë. Atë anën personale. Njerëzore. Hashimin idealist, ëndërrimtar, vizionar, mirënjohës e falënderues, negociator e të vendosur, punëtor e besnik, mentor e lider”, ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se ka mjaft nga ata që dje e kanë sharë, por që sot e

kërkojnë. “Ka mjaft të tjerë që edhe sot e kontestojnë, por nesër do ta vlerësojnë. Ama asnjë nuk mund ta cenojë rolin e pazëvendësueshëm të Hashim Thaçit në historinë e Kosovës dhe të kombit shqiptar - udhëheqësit politik të luftës çlirimtare dhe shpallësit të pavarësisë së shtetit tonë. Unë besoj se fati u prinë guximtarëve dhe të drejtëve. Prandaj, nuk kam dyshimin më të vogël se edhe në këtë betejë të tij të fundit, presidenti Thaçi do të dalë fitimtar”, është shprehur Krasniqi. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka thënë se ky është një libër tepër i

rëndësishëm, duke theksuar se drejtësia vendoset duke e dënuar të padrejtin dhe jo të drejtin - çlirimtarin. Ai ka thënë se objektivi për çlirimin e vendit u arrit. Arta Dade ka theksuar se në këtë libër janë të përfshirë ngjarjet më kryesore. “Jeta e një personaliteti si Hashim Thaçi mund të përshkruhet në dhjetë ose njëzet libra. Autorët kanë nxjerrë momentet më kryesore”, ka thënë Dade. Libri “Shtet i ri, burrë shteti modern: Hashim Thaçi, një biografi” kohë më parë është promovuar edhe në Tiranë.



Në praninë e mbi 200 mysafirëve, Konsullata e Kosovës në Nju-Jork feston 16-vjetorin e Pavarësisë

PRISHTINË, 16 SHKURT - Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju-Jork ka organizuar pritje me rastin e 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës për korin diplomatik të OKB-së dhe bashkatdhetarët. Shefi i Misionit në Konsullatën

e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka theksuar se bashkë me ambasadorin amerikan Robert Wood, nga Misioni i ShBA-së në OKB, hapen mbrëmjen festive të 16-vjetorit të Pavarësisë së

Kosovës në praninë e mbi 200 mysafirëve.

“Në 25-vjetorin e çlirimit të vendit, lufta e lavdishme çlirimtare dhe shtet-ndërtimi demokratik, është rrëfim suksesi. Përrjetësisht Republika e Kosovës!”, ka shkruar Reka në “Facebook”.





PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA MARRË URIM PËR 16-VJETORIN E PAVARËSISË
NGA PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, JOE BIDEN

Bideni: E inkurajojmë Kosovën t'i përmbushë obligimet nga dialogu me Serbinë

Presidenti amerikan, Joe Biden, në letrën e urimit për 16-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dërguar presidentes Vjosa Osmani, ka konfirmuar se Kosova dhe ShBA-ja ndajnë një miqësi dhe partneritet të qëndrueshëm të përforcuar nga vizioni i përbashkët për një rajon më paqësor, më të sigurt dhe më prosperues. Ai ka thënë se ShBA-ja e inkurajon udhëheqjen e Kosovës t'i përmbushë të gjitha obligimet e dala nga dialogu me Serbinë, përfshirë të gjitha marrëveshjet e arritura përmes këtij procesi

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 SHKURT - Presidenti amerikan Joe Biden, në urimin e tij për 16-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e inkurajoi udhëheqjen në Kosovë t'i përmbushë të gjitha obligimet nga dialogu për normalizim të raporteve me Serbinë. "Së bashku me shtetet e tjera në rajon dhe mbarë botën, ShBA-ja inkurajon udhëheqjen e Kosovës që t'i përmbushë të gjitha obligimet, përfshirë edhe të gjitha marrëveshjet e arritura përmes këtij procesi", ka theksuar Bideni në urimin dërguar presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. Udhëheqësi amerikan tha se Shtetet e Bashkuara dhe

Kosova ndajnë një miqësi dhe partneritet të qëndrueshëm "të forcuar nga vizioni ynë i përbashkët për një rajon më paqësor, më të sigurt dhe më prosperues". "Ne vazhdojmë t'i mbështesim përpjekjet e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja drejt arritjes së një m a r r ë v e s h j e j e gjithëpërfshirëse për normalizim me Serbinë - një hap i rëndësishëm drejt njohjes eventuale reciproke", ka pohuar Biden. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog për normalizimin e raporteve, me lehtësim të BE-së, që nga viti 2011. ShBA-ja mbështet këtë proces, por nuk është pjesë e tij. Palët ndër vite kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar në praktikë. Një prej

marrëveshjeve që faktori ndërkombëtar i kërkon me ngulm Kosovës që ta zbatojë është ajo për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Qeveria e Kosovës ka shprehur drojën se një asociacion i tillë njëetnik mund ta dëmtojë funksionalitetin e shtetit të Kosovës. Po ashtu, vitin e kaluar palët arritën një marrëveshje në rrugën drejt normalizimit dhe u pajtuan edhe për aneksin e zbatimit të saj. Marrëveshja për normalizim, prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu,

të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

BE-ja ka thënë se marrëveshja, që nuk është nënshkruar, por është obligative për palët, ende nuk ka nisur të zbatohet.

**Blinkeni: Dialogu,
e vetmja rrugë përpara
për Kosovën dhe
Serbinë**

Edhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, ka thënë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetëson Bashkimi Evropian, është rruga e duhur dhe e vetme për dy vendet që të lëvizin përpara. "Po bëjmë gjithçka të mundur për t'i mbështetur ato", ka pohuar ai. Ai ka theksuar se ShBA-ja do të punojë edhe me "Shqipërinë dhe të tjerët" për t'i ndihmuar Kosovën e Serbinë që të avancojnë drejt normalizimit të marrëdhënieve. Ai shtoi se vendi i tij e di se çfarë ka ndodhur në rajon 30

vjet më parë, ndaj "nuk mund të ketë përsëritje të saj". "Për këtë arsye jemi të angazhuar t'i mbështesim të gjitha përpjekjet për ta çuar përpara integrimin e gjithë Ballkanit Perëndimor", ka theksuar Blinken.

Blinkeni nuk iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve për një vendim të autoriteteve në Kosovë, që ndaloi përdorimin e dinarit serb në vend, pas më shumë se dy dekadash.

Duke shprehur shqetësim për komunitetin serb në Kosovë, që prej vitësh merr pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia, ShBA-ja i kërkoi Qeverisë së Kosovës që ta tërheqë atë, por kjo e fundit nuk u zbraps.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë një ditë më parë se vendimi për dinarin "e ka ndikuar cilësinë e marrëdhënieve" mes ShBA-së dhe Kosovës. "Ne kemi shpresuar se qeveria e kryeministrit Albin Kurti do të angazhohej, siç bëjnë partnerët, për ta zgjidhur këtë

Limaj: Një grup individësh janë ngritur në këmbë për ta rrënuar këtë shtet

PRISHTINË, 16 SHKURT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i ka quajtur populiste veprimet e qeverisë Kurti karshi faktorit ndërkombëtar.

Kreu i Nismës tha se një qeveri normale do të duhej t'i vazhdonte punët ku kanë mbetur e jo t'i "përmbysë krejt çka është bërë". Sipas Limajt, veprimet eksperimentale të qeverisë po i kushtojnë Kosovës në raport me zhvillimet e brendshme dhe jashtë.

Limaj i sheh këto veprime si tendencë për ta rrënuar shtetin nga një "grup individësh". "Besoj se të gjithë tashmë jemi të qartë çka do të thotë politika populiste kur politikën e jashtme e përdorni për përfitime të brendshme. Kur nuk dini për të dalluar interesin strategjik me poteza të përditshme politike, ato i kushtojnë vendit. Ky vazhdimisht ka qenë apeli im që Kosova duhet ta ruajë kursin e vet properëndimor. Kosova duhet të bëjë hapa të sigurt për rumbullakimin e shtetësisë së



vet. Kjo, fatkeqësisht, po ndodh tash e tri vjet. Këto janë veprime eksperimentale që po i kushtojnë dhe do t'i kushtojnë vendit tonë në mënyra të ndryshme", ka thënë Limaj për "Ekonomia Online".

Duke komentuar deklaratat e ambasadorit amerikan Jeffrey Hovenier, për dëmtimin e partneritetit të ShBA-së me Kosovën, Limaj tha se janë dëshmitarë të shkatërrimit të "shtetit të ndërtuar me shumë sakrificë dhe mund". "Qeveria është duke bërë gabime që nga fillimi, sepse tash e ka ndërruar

kursin e drejtimit të vendit. Mentaliteti për të filluar çdo gjë prej zeros, duke përmbysur të arriturat, është mentalitet që e përmbys vendin. Një vend i qytetëruar, një qeveri normale, e pjekur, vazhdon aty ku ka mbetur për ta bërë edhe më mirë seç është për ta ndryshuar më mirë, por jo për ta përmbysur krejt se çka është bërë. Fatkeqësisht, jemi dëshmitarë që grupe individësh janë ngritur në këmbë për të rrënuar këtë shtet të ndërtuar me shumë sakrificë dhe mund tash e 20 vjet", ka thënë Limaj.

Moj Kosovë mos thuj marova, se Shqypnia hala â gjall'



Muhamet MAVRAJ

siguresë e radhës në hartën tonë.

Nesër është përvjetori i shtetësisë së Kosovës. Burrat që e shpallën këtë shtet e dërguan veten në burg (Hagë) që të mos cenohej madje as hija e miqësisë shqiptaro-amerikane.

Një Kosovë e miqësuar me Amerikën e dëboi Serbinë (1999). Vetëm një Kosovë e prishur me Amerikën dhe nën sanksione evropiane mund ta kthejë shpresën serbe. Kjo është saktësisht në thelb të skicës serbe pas humbjes së Kosovës më 1999. Pavarësisht prej investimeve antiperëndimore këndejpri, do të dështojë kjo skicë për mijëra arsye, pse jo, edhe për shkak se e kemi Shqipërinë në pikë të saktë. Jam optimist.

Na nderon, si komb, vizita amerikane në Shqipëri (e sekretarit Blinken), si përzgjedhje e tërë rajonit. Do të ishte më e plotë po të vizitohej edhe Kosova, por vizitat e larta janë bllokuar moti. Këndejpri Trumpin nuk e deshëm, as Bidenit s'po ia dimë rendin...

Hapja e bazës ajrore amerikane pas pak javësh në Shqipëri është edhe një

Ish-zëvendësshefja e NATO-s: Evropa vështirë mund ta zëvendësojë mbrojtjen amerikane

PRISHTINË, 16 SHKURT - Ish-zëvendësja e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Rose Gottemoeller, thotë se "ftesa" që ish-presidenti amerikan Donald Trump ia bën Rusisë për ta rritur agresionin, "është e tmerrshme dhe skandaloze". "Nuk do ta kuptoja prej askujt, aq më tepër prej një kandidati për president të Shteteve të Bashkuara", thotë ajo. Në një intervistë dhënë Radios Evropa e Lirë, Gottemoeller thotë se Evropa vështirë se do të mund ta zëvendësonte mbrojtjen që ofron ShBA-ja, nëse kjo e fundit - në një situatë hipotetike - tërhiqet nga NATO-ja.

Trumpi, i cili pritet të garojë sërish për president në zgjedhjet e nëntorit, ka kritikuar vazhdimisht aleatët e NATO-s se nuk



shpenzojnë sa duhet në mbrojtje, ndërsa ka përmendur edhe mundësinë e tërheqjes së ShBA-së nga aleanca perëndimore. Gottemoeller thotë se Evropa duhet të fokusohet tani në

modernizimin e armatimit të saj. Duke folur për Kosovën, thotë se për një kalim të suksesshëm të FSK-së në ushtri, ajo duhet të përqendrohet në "stërvitje, stërvitje, stërvitje".



çështje së bashku, në vend se të merren veprime në mënyrë të njëanshme... ne jemi të shqetësuar që qeveria e Kurtit nuk e ka bërë këtë. Çfarëdo sugjerimi se gjërat janë në rregull, se ne të gjithë pajtohemi me njëri-tjetrin, nuk është aspak i vërtetë. Ne jemi të shqetësuar dhe të frustruar dhe mendoj se toni i ndihmëssekretarit O'Brien e pasqyron këtë shumë qartë", ka thënë Hovenieri.

Hovenieri ka theksuar se është "gjë e rrallë" që Kosova të kritikohet nga Shtetet e Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke iu referuar fjalimit të ambasadores amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, e cila e ka përsëritur kërkesën e shtetit të saj që Kosova ta pezullojë zbatimin e vendimit të BQK-së gjatë një seance më 9 shkurt ku u bisedua me kërkesë të

Serbisë për çështjen e dinarit. "Është e rrallë që në Këshill të Sigurimit përfaqësuesi amerikan të thotë gjëra kritike për Qeverinë e Kosovës. Ambasadorja Linda-Thomas Greenfield e bëri këtë. Është e rrallë që ndihmëssekretari për Evropë, James O'Brien, të japë intervistë me tone e kontekst të tillë siç e bëri. Është shumë e rrallë. Reflekton për një problem. Shpresa ime është të ndalet kjo. Nuk duam të jemi

në këto rrethana. Duam të jemi në rrethana të tjera", ka deklaruar diplomati amerikan. Ambasadori Hovenier ka folur për mundësinë e ndonjë mase sanksionuse ndaj Kosovës nëse qeveria nuk reflekton ndaj kërkesës së ShBA-së. I pyetur për këtë çështje, ai ka thënë se nuk është në pozitën për të folur për ndonjë masë specifike. "Kjo na bëhet shpesh si pyetje. Është bërë e njëjta gjë edhe në Departamentin e

Shtetit. Dhe është thënë se nuk jemi në pozitën për të folur për ndonjë masë specifike dhe këtë mund ta them edhe unë. Por po them prapë, siç e ka thënë z. O'Brien, ne do të shpresonim që qeveria dhe kryeministri Kurti do të angazhohen si partnerë që ta zgjidhim këtë çështje së bashku në vend se të marrë veprime të njëanshme", ka thënë Hovenieri.

Sveçla pret ambasadorin e Australisë, diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit në fushat që mbulon MPB-ja

PRISHTINË, 16 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të premten në takim ambasadorin jorezident të Australisë në Kosovë, Richard Rodgers. Ministri uroi Rodgersin për detyrën e tij si ambasador jorezident në Republikën e Kosovës dhe me këtë rast ministri Sveçla dhe

ambasadori Rodgers biseduan për situatën aktuale të sigurisë në Kosovë si dhe për marrëdhëniet bilaterale që gëzojnë dy shtetet tona në fushën e sigurisë.

Me rastin e 16-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ambasadori Rodgers përcolli

urimet e tij për ministrin dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ministri Sveçla dhe ambasadori Rodgers u pajtuan për komunikim të mëtejshëm në frymën e thellimit të bashkëpunimit në fushat që mbulon Ministria e Punëve të Brendshme.



Quinti mbështet grupin e serbëve të kritikuar nga Bislimi

PRISHTINË, 16 SHKURT - Pasi zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, shprehu një sërë kritikash ndaj takimit të të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, me një grup të komunitetit serb nga shoqëria civile, mediet dhe zyra e Avokatit të Popullit - ambasadorët e shteteve të Quintit në Kosovë - thonë se ata "përfaqësues të serbëve të Kosovës janë partnerë të besueshëm". "Ambasadorët e Quintit [ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia] dhe BE-së vlerësojnë mundësinë për t'u takuar sot me zëvendësin e Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës - të cilët janë partnerë të besueshëm në përpjekjet tona të përbashkëta për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe marrëdhënieve ndëretnike për Kosovën", ka shkruar ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, në rrjetin social "X", që më herët njihet si "Twitter".

Ky grup i serbëve, duke përfshirë zëvendësin e Avokatit të Popullit në Kosovë, Sërgjan Sentiq, Jovana Radosavljeviq dhe Miodrag Miliceviq nga organizatat joqeveritare Iniciativa e Re Sociale dhe Aktiv, drejtorin e RTV-së lokale, Kim Isak Vorguçiq dhe Dragisha Mijaciqin nga grupi punues i Beogradit i Konventës Kombëtare për Bashkimin Evropian, u takuan me Lajçakun më 13 shkurt në Bruksel.

"Gjithmonë ndihmon kur dëgjohe zëra nga terreni", ka shkruar Lajçaku në një postim në rrjetin social "X" pas atij takimi. Kësaj zëvendëskryeministri i Kosovës iu përgjig duke njoftuar se në takimin me Lajçakun ishte një "delegacion i përbërë kryesisht nga organizata



joqeveritare serbe nga Kosova, të cilat në mënyrë aktive dhe hapur avokojnë kundër integritetit të qytetarëve serbë në sektorin ekonomik dhe në jetën sociale të Kosovës".

Këto takime të serbëve me diplomatët ndërkombëtarë ndodhën në kohën kur Kosova është nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare për ta shtyrë vendimin për shfuqizimin e dinarit serb. Vendet perëndimore besojnë se vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës, i cili parasheh euron si valutë të vetme për transaksionet e parave të gatshme dhe pagesave, mund të ketë ndikim negativ në komunitetin serb.

Shteti serb ndan miliona euro për

serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë. Autoritetet e Kosovës kanë thënë se vendimi i BQK-së nuk e ndalon Serbinë që të vazhdojë t'i ndihmojë serbët në Kosovë, por ato duhet të paguhet në euro.

Në të njëjtën kohë, që nga fundi i janarit janë mbyllur shtatë komuna paralele serbe që funksionojnë nën sistemin e Serbisë e që Kosova i konsideron të paligjshme. Po ashtu, janë mbyllur edhe zyrat e organizatës joqeveritare Qendra për Paqe dhe Tolerancë në qendër të Prishtinës me arsyetimin se aty janë ofruar "shërbime të paligjshme mjekësore".

Me këtë rast, më 8 shkurt, sektori

civil serb ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që t'i ndalojë veprimet që pengojnë punën e institucioneve serbe në Kosovë dhe të gjendet një zgjidhje përmes formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, për të cilën është rënë dakord në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Ndërkohë, disa organizata joqeveritare nga komuniteti shqiptar reagojnë ndaj kritikave të Bislimit me mesazhin se ato janë "të pabaza dhe të dëmshme". "Kërkojmë respekt të sinqertë dhe të pakushtëzuar të parimeve themelore demokratike të garantuara me Kushtetutën e Kosovës", thuhet në deklaratën e nënshkruar nga disa organizata joqeveritare dhe individë.

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, është shprehur e zhgënjyer dhe e shqetësuar për deklaratat e Bislimit dhe ka vlerësuar se organizatat joqeveritare që kanë hasur në kritikën e tij, "punojnë pa u lodhur në integrimin brenda Kosovës".

Po ashtu, organizata joqeveritare "Aktiv" bëri me dije se kritikën e zëvendëskryeministrit të Kosovës janë "sulm ndaj shoqërisë së lirë për të cilën ne qëndrojmë".

Iniciativa e Re Sociale sqaroi gjithashtu se Konventa Kombëtare për Bashkimin Evropian përbëhet edhe nga një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që është e pavarur në punën e tij dhe nuk përfaqëson pikëpamjet e asnjë organi shtetëror, organizate bilaterale apo ndërkombëtare. "Ne nuk e shohim dialogun si një rivalitet midis dy palëve armiqësore, por si një proces që duhet të mundësojë paqe të qëndrueshme, një jetë më të mirë për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga përkatësia kombëtare apo etnike, si dhe prosperitet për të gjithë rajonin", tha kjo nismë.

Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë më shumë se dhjetë vjet që zhvillojnë procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, por shpesh palët i interpretojnë ndryshe marrëveshjet e arritura dhe akuzojnë palën tjetër për shkeljen e tyre.

Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia e kanë pranuar marrëveshjen e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve dhe aneksin për zbatimin e saj. Megjithatë nuk është nënshkruar, BE-ja ka thënë se marrëveshja është ligjrisht e detyrueshme për të dyja palët. /Rel


ShSKUK-ja dhe Oda e Mjekëve arrijnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 16 SHKURT - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës dhe Oda e Mjekëve të Kosovës kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë për ta siguruar avancimin e personelit mjekësor përmes bashkëpunimit të ndërsjellë

në përparimin e njohurive shkencore dhe praktike në fushën e mjekësisë.

Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi dhe kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, dr. Pleurat Sejdiu. Kjo marrëveshje ka për synim avancimin e vlerave

profesionale dhe integritetit të pozitës së mjekut si profesionist shëndetësor, me angazhimin për të dhënë kontributin në forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.



Gërvalla takon sekretaren e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, flasin për sigurinë nacionale dhe globale

PRISHTINË, 16 SHKURT - Situata e sigurisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, partneriteti në shumë fusha dhe mbështetja në fushën e sigurisë, ishin temat kryesore të takimit që zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, pati në margjinat e Konferencës së Sigurisë në Muni, me

sekretaren e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, Susanne Baumann.

Gjatë takimit bilateral, ministrja Gërvalla vuri në pah veprimet e vazhdueshme destabilizuese të Serbisë, nevojën e ndërmarrjes së hapave konkretë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në

Ballkanin Perëndimor. "Siguria nacionale dhe globale si dhe rreziqet me të cilat po përballet ajo janë sfida të të gjitha shteteve dhe vetëm me një bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim të veprimeve të përbashkëta mund të arrijmë që të krijojmë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në botë", tha ministrja Gërvalla.



Haradinaj dhe Limaj vizitojnë Prekazin, priten në kullë nga Rifat Jashari



PREKAZ, 16 SHKURT - "Komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja Jashari ishin vazhdimësi e përpjekjeve qindrvjeçare të shqiptarëve për liri. Guximi për të vepruar hapur e gatishmëria për sakrificë, e dallojnë komandantin tonë dhe familjen e tij nga të gjitha etapat e kaluara të historisë sonë. Liria e shteti ynë i ka rrënjët pikërisht aty ku kulmuan ato përpjekje të pareshtura, në Prekazin legjendar. Në prag të 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës kujtojmë e nderojmë të gjithë anëtarët e kësaj familje, që shërbeu si shembulli më frymëzues i guximit për të luftuar për çlirim dhe pavarësinë e Kosovës", kështu ka thënë Ramush Haradinaj me rastin e vizitës në kullën e Jasharëve, i shoqëruar edhe nga Fatmir Limaj. Haradinaj ka thënë se në këtë ditë

të veçantë vazhdojnë të përforcojnë më shumë se kurrë përkushtimin ndaj vlerave të lirisë, për të cilën familja Jashari dhe shumë të tjera janë sakrifikuar. "Duhet të angazhohemi pareshtur për forcimin e shtetësisë sonë duke qenë në rresht me aleatët tanë në krye me ShBA-në, si anëtarë e NATO-s. Para nderimeve të të rënëve për liri u mirëpritëm nga i pari i kësaj familje emblematike, baca i shqiptarëve, Rifati. Si gjithmonë, plot jetë e pozitivitet, zemërgjerësi e dashuri për miqtë, luftëtarët e lirisë, Kosovën e kombin përgjithësisht. Kjo shtëpi e madhe e kombit, gjithmonë me dyer të hapura për miliona shqiptarë e miq ndërkombëtarë. Lavdi dhe respekt për familjen Jashari dhe për të gjithë të rënë të ranë për lirinë e Kosovës!", ka thënë Haradinaj.

Shënohet Dita Nacionale e Komunitetit Ashkali, qeveria premtion kushte më të mira për komunitetet

PRISHTINË, 16 SHKURT - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, mori pjesë në eventin e organizuar për Ditën Nacionale të Komunitetit Ashkali. Në këtë event, në mesin e shumë pjesëmarrësve, ishin edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, zëvendëskryeministrja e tretë, Emilija Rexhepi, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe deputetë të Kuvendit nga radhët e minoriteteve dhe shefi i zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Në fjalën e tij zëvendëskryeministri Bislimi theksoi se në këtë ditë kaq të veçantë duhet të ndihemi krenarë për vlerat tuaja si komunitet, për

arritjet aktuale dhe kontributin në Kosovën e suksesshme, dinamike dhe multietnike, si dhe për përfaqësimin tuaj të denjë e të përkushtuar gjatë këtyre viteve. "Kosova krenohet për faktin që ka shkencëtarë/e ashkali, sportistë/e ashkali, policë/e ashkali, mësues/e ashkali, aktivistë/e ashkali, shkrimtarë/e ashkali, biznesmenë/e ashkali, dhe shumë anëtarë të tjerë të komunitetit që kontribuojnë në shtetin tonë", ka theksuar zëvendëskryeministri Bislimi, duke shtuar se mirëqenia e komuniteteve pakicë, zbutja e diskriminimit, zhvillimi social dhe ekonomik janë disa nga prioritetet e qeverisë Kurti. "Andaj edhe do të mundohemi gjithmonë që së

bashku të gjejmë zgjidhje për çdo sfidë, sepse vetëm së bashku mund t'ia dalim dhe ta përmirësojmë edhe më tej kualitetin e jetës së qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve. Qeveria e Kosovës e ka dëshmuar përkushtimin dhe angazhimin e saj për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë qytetarët, në mënyrë që të arrijmë të krijojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku të gjithë përfitojnë në mënyra të ndryshme e me impakt të drejtpërdrejtë", ka deklaruar ai, duke shtuar se do të punojnë bashkërisht dhe të përkushtuar për të gjitha moshat. "Për një jetë sa më të mirë dhe për një shoqëri gjithëpërfshirëse e të barabartë", ka përfunduar fjalën e tij zëvendëskryeministri Bislimi.



Krasniqi pret në takim ambasadorin amerikan: ShBA-ja, kryealeatja strategjike e Kosovës



PRISHTINË, 16 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të premten në selinë e partisë ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, me të cilin ka diskutuar rreth zhvillimeve të fundit politike në vend. "Në

prag të shënimit të 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, duke vlerësuar lart mbështetjen e pakusht e të parrezervë të SHBA-ve në rrugëtimin e gjatë të vendit tonë drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit, theksova se është thelbësore ruajtja dhe thellimi i partneritetit me

ShBA-të - kryealeatin strategjik të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë të angazhohet në këtë drejtim, të luaj rol konstruktiv në avancimin e raporteve të mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Mbi 180 mijë kartëmonedha prej 500 eurosh janë tërhequr nga qarkullimi

PRISHTINË, 16 SHKURT - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka njoftuar se si efekt i Rregullores për Operacione me Para të Gatshme numri i kartëmonedhave prej 500 eurosh të deponuara nga qytetarët në bankat komerciale dhe më pas në BQK, si para të tërhequra nga qarkullimi, ka kaluar mbi 180 500 njësi, duke tejkaluar vlerën e 90 milionë e 250 mijë eurove. BQK-ja ka theksuar se ky është

ndër efektet e drejtpërdrejta të rregullores që nga miratimi i saj, duke kontribuar në arritjen e qëllimit për një sistem financiar me integritet dhe që ndihmon në strategjinë kombëtare kundër informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura. Rregullorja për Operacione me Para të Gatshme, përveç të tjerash, përcaktoi që të gjitha institucionet financiare bankare dhe jobankare janë të

obliguara ta ndalojnë riqarkullimin e kartëmonedhës 500 euro te klientët e tyre. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për ta avancuar kornizën ligjore dhe mbikëqyrëse në zbatim të mandatit të saj kushtetues dhe në pajtim me objektivat strategjike të saj, me transparencë dhe përkushtim ndaj publikut.



Guvernatori i BQK-së e pret në takim ambasadorin francez, e informon për sistemin financiar në Kosovë

PRISHTINË, 16 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendës guvernatorin Fusha, kanë pritur të premtën në takim ambasadorin e Francës në vendin tonë, Olivier Guerot, i shoqëruar nga Pierre Grandjouan. Guvernatori Ismaili e ka njoftuar ambasadorin Guerot lidhur me aktualitetet në sistemin financiar të vendit, zhvillimet makroekonomike, perspektivën, objektivat dhe planin strategjik të BQK-së, nismat për avancimin e sistemit financiar, përfshirë projektin për modernizimin e sistemit të pagesave dhe synimin për anëtarësimin në zonën e vetme të pagesave euro të Bashkimit Evropian, i njohur si SEPA.

Me këtë rast, guvernatori i BQK-së shprehi vlerësimet dhe konsideratat më të larta për mbështetjen nga Banka e Francës, e cila ka kontribuar në projekte të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndihmën e popullit francez për popullin e Kosovës.

Sipas njoftimit për medie, në takim u diskutua edhe për avancimin e kornizës rregullative dhe ligjore, duke përfshirë Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimin e Pagesave dhe ligje të tjera të cilat kanë si synim përafrimin me direktiva të BE-së.

Po ashtu, është biseduar lidhur



me veprimet e ndërmarra ndaj parave të falsifikuara si dhe planet e tjera për fuqizimin e integritetit të sistemit financiar, me praktikat më të mira ndërkombëtare. Guvernatori Ismaili e informoi ambasadorin Guerot mbi Rregulloren për Operacione me Para të Gatshme, duke sqaruar aspektet kryesore, efektet dhe argumentet për pozicionin e saj. U sqarua se rregullorja avancoi integritetin e sistemit financiar

dhe përafron Republikën e Kosovën me standardet e BE-së. Ambasadori francez u njoftua edhe për planin e BQK-së për zbatimin e kësaj rregulloreje në praktikë, si dhe veprimet për lehtësimin e efekteve të saj, krahas angazhimit konstruktiv të BQK-së për lehtësimin e transferimit të mjeteve sipas modelit të propozuar dhe gatishmërisë për të diskutuar opsionet e mundshme ligjore.

Sa iu përket shqetësimeve të ngritura lidhur me ndikimet e saj në një komunitet të caktuar, u sqarua se rregullorja në fjalë nuk ndalon apo kufizon pranimin e mjeteve në llogaritë bankare në euro dhe as nuk kufizon aktivitetin këmbimor që kryhen nga institucionet financiare bankare ose jobankare të licencuara nga BQK. Në fund u tha se BQK-ja në mënyrë aktive po vazhdon

aktivitetet e informimit dhe sensibilizimit, përfshirë lëshimin e linjës pa pagesë të dedikuar për qytetarët tanë dhe materiale të tjera informuese, duke i ftuar ata që ende nuk kanë llogari, të hapin një të tillë te secila bankë, e cila për grupe të cenueshme nuk ka tarifë të hapjes e as të mirëmbajtjes nga 1 janari 2024 me Rregulloren e BQK-së për Qasje në Llogari Pagese për Shërbime Bazike.

Kurti takoi përfaqësues të kompanive gjermane, i fton për investime në Kosovë

PRISHTINË, 16 SHKURT - Qëndrimin në Muni, për të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga shefi i stafit, Luan Dalipi dhe ambasadori i Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, e filloi të premtën me një mëngjes pune me përfaqësues të bizneseve gjermane, të organizuar në bashkëpunim me Këshillin e Jashtëm mbi Marrëdhëniet Ekonomike (Foreign Councils on Economic Relations). Gjatë bashkëbisedimit Kurti nënvizoi indikatorët ekonomikë të vendit dhe progresin e Kosovës si një

shtet zhvillimor, progresist dhe demokratik. Ai renditi përparësitë demografike dhe gjeografike, politikat e favorshme fiskale, të rinjtë profesionistë, reformën dhe përmirësimin në sundimin e ligjit dhe stabilitetin institucional, si arsye se pse e bëjnë Kosovën ambient të favorshëm për investime të huaja.

I njoftoi për planet dhe potencialin e investimeve në vendin tonë në shumë fusha. Ndër to, u theksua sektori i energjisë, përkatësisht energjisë së ripërtëritshme, ku së fundmi u përmyll me sukses procesi i ofertimit për

ankandin e parë solar 100 MW dhe së shpejti pritet të hapet thirrja për ankandin tjetër, të erës, me kapacitet 150 MW. Gjithashtu, kryeministri foli edhe për fillimin e zbatimit të arsimit dual në 21 shkolla profesionale, në 14 komuna me qëllim të ndërlidhjes së arsimit me tregun e punës, si dhe për Fondin Sovran, i cili do të sjellë një cikël të ri investimesh në vend, duke e lidhur Kosovën me tregjet botërore financiare. Në këtë kontekst, ai i ftoi kompanitë gjermane ta vizitojnë Kosovën dhe t'i konsiderojnë mundësitë që ofron ajo për investime.



Debati për 'teorinë' e re për vdekjen, varrimin dhe zhdukjen e trupit të pajetë të Fishtës!

Arben Lagreta, që e cilëson veten si gazetar hulumtues, kohëve të fundit ka nxitur debate në lidhje me vdekjen dhe varrimin e trupit të pajetë të Gjergj Fishtës. "Hulumtimi" i tij bazohet në një bisedë me një shkollan, profesorin e shkencave bujqësore Ahmet Osja (1939-202) i cili ishte një vjeç kur ka vdekur Fishta, dhe konkludon se Fishta është helmuar me urdhër të Benito Mussolinit, se është varrosur në kishën e Shirqit dhe se trupi i tij zhvarrosët nga italianët dhe se zhduket në Romë. "Hulumtimin" e vet Lagreta po ashtu e bazon në bindjet dhe interpretimet personal për françeskanët, jezuitët dhe Vatikanin në përgjithësi. Mirëpo, përkitazi me vdekjen dhe varrimin e Fishtës, dëshmitë janë të shumta dhe ato i risjellin në kujtesë studiuesit e jetës dhe veprës së Fishtës, Frano Kulli dhe Ernest Marku. Pos kësaj, ekzistojnë edhe dëshmitë përmes fotografive të realizuara nga Gegë Marubi. Debatin e botuar në gazetën "Panorama", mund ta lexoni si më poshtë.

GJERGJ FISHTËN E HELMOI MUSOLINI, DY USHTARAKË ITALIANË E ZHVARROSËN NGA KISHA E SHIRQIT DHE TRUPIN E ÇUAN NË ROMË?!

Nga: Arben LAGRETA

Që Atë Gjergj Fishta ishte helmuar nga Musolini këtë ka rreth një dekadë që e dija nga bisedat me qytetarë të moshuar shkollanë të cilëve u kishin folur për këtë fakt ende të panjohur priftat franceskanë që kanë jetuar deri në vitet 2000.

Por, jo vetëm ata. Po kështu dhe nga të njëjtët burime dija edhe faktin tjetër akoma më të rëndë se trupin e Fishtës e kishin zhvarrosur italianët vetëm pak kohë pas vdekjes dhe e kishin zhdukur. Një ngjarje e tillë mund të anashkalohej apo edhe të fshihej nëse do t'i kishte ndodhur një njeriu të zakonshëm, por jo në rastin e një personaliteti si Atë Gjergj Fishta me kontribute të shquara patriotike, si shkrimtar dhe si prelat i lartë fetar në Shkodër. Për fat të keq në vazhdim e një tradite jo të mirë në kryeqendrën e Veriut, Shkodër, sipas së cilës "ca po më duhet mua që të flas për këto gjana, le të merren të tjerët se janë gjana me zarar" etj. si këto, ky fakt i çmueshëm historik nuk shkoi përtej bisedave nën zë në Kafën e



Pamje nga ceremonia mortore e varrimit të Gjergj Fishtës (foto: Gegë Marubi, 1940)

Madhe, në kafeteritë e Piacës, Gjuhadorit e Parrucës si dhe në bisedat konfidenciale në përgjithësi të qytetarëve shkollanë që e përcillnin këtë kuriozitet të njëri-tjetri.

Ndërkohë, këtë informacion e verifikova në vitin 2017 gjatë një bisede të lirë me prof. Ahmet Osja ku nuk isha përgatitur për ta intervistuar. Për këtë i duhej gjetur rasti i përshtatshëm edhe për një fakt.

Prof. Ahmet OSJA

Profesori dhe akademiku i njohur i Institutit të Misrit dhe Orizit në Shkodër, Prof. Dr. Ahmet Osja ka ndërruar jetë para afro katër vjetësh, në shkurt të vitit 2020. I nderuar edhe me titullin prof. Honoris Causa në disa universiteteve perëndimore në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ai ka qenë një ndër specialistët më të mirë të bujqësisë në Shqipëri, por në të njëjtën kohë një mendje e ndritur me një bagazh shumë të gjerë kulturor që tejkalonte njohuritë në fushën e tij. Periudhën më të gjatë të karrierës së tij ai ka punuar si specialist dhe drejtues në Institutin e Misrit dhe Orizit në Shkodër deri në fillim të viteve 2000 kohë në të cilën edhe doli në pension. Në vitet '80 ka qenë deputet i Kuvendit Popullor në një legjislaturë, ndërsa në vitin 1991 Ahmet Osja ka qenë ministër i Bujqësisë në qeverinë e parë postkomuniste Nano 1. Qytetarët shkollanë e mbajnë mend mirë ndershmërinë dhe idealizmin që ai demonstroi në ato pak muaj kur ishte në detyrën e ministrit. Mjafton të përmend një detaj: Gjatë asaj periudhe, vajtje-ardhjet për fundjavë në Shkodër nga Tirana dhe në kthim prof. Ahmet Osja nuk i bënte me makinën e ministrit që i takonte me ligj, por

me tren.

Nga viti 2000 dhe derisa ndërroi jetë kisha miqësi personale me të sepse çdo herë që takoheshim, bisedoja dhe mësoja prej tij gjëra që nuk i dinte askush. Ahmet Osja shumë rrallë pranonte që të ulej për kafe apo çaj me të gjithë, sepse i pëlqente që të fliste në këmbë dhe në lëvizje aq më tepër që ndalohej në rrugë nga 20 deri në 30 persona në ditë të cilët, kush më shumë e kush më pak, donin që të përfitonin sado pak nga bagazhi i tij duke e respektuar dhe biseduar me të. Osja ishte erudit dhe me kulturë të gjerë njëllor si një enciklopedi e gjallë dhe kishte një memorie kompjuterike sidomos përsa i takon datave të ngjarjeve të ndryshme historike. Me të takohesha më shpesh në parkun e madh të gjelbëruar pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës që është shumë pranë pallatit ku banonte dhe ka mbetur i paprekur që prej shumë dekadash. Nuk mbaj mend që ai të mos më ketë dhënë shpjegime qoftë edhe për një nga pyetjet që i bëja, nisur edhe nga natyra ime kurioze.

Deri pak ditë para se të ndërrohte jetë, prof. Osja vijonte regjimin e tij të përditshëm duke studiuar çdo ditë deri rreth orës dy pas mesit të natës në bibliotekën e tij, e cila radhitet si një ndër bibliotekat familjare më të pasurat e profesorëve dhe akademikëve që ka nxjerrë Shkodra.

Kur prof. Osja po i mbushi të tetëdhjetat i sugjeroja që disa prej fakteve historike ende të panjohura që ai donte t'i botoja në shtypin e shkruar, duke iu referuar atij, por ai nuk ishte dakord. Ia kërkova këtë edhe për faktin se gjatë gjithë kohës së gjatë të njohjes dhe miqësisë sonë ai kishte pranuar që të më jepte vetëm një intervistë për turizmin

në Shkodër që u pat botuar në një gazetë të përditshme ("Sivjet do të duhej që të festonim 70-vjetorin e turizmit", gazeta "Tema", 2006). Por, kjo ishte shumë pak në raport me dëshmitë dhe faktet e panjohura nga askush në këtë vend që dilnin nga goja e tij gjatë këtyre bisedave me të që shkonin edhe me orë të tëra.

Sidoqoftë, kur në vjeshtën e vitit 2018, duke qenë edhe më i paduruar në kërkesën time të përhershme i thashë shkurt dhe prerë se "unë nuk mund të jem vetëm dëgjues i këtyre dëshmimeve por do t'ju regjistroj për pjesën e përgjigjeve të pyetjeve të mia". Kësaj here, mbase edhe i lodhur nga këmbëngulja ime prof. Osja nuk kundërshtoi. Mesazhi i tij i koduar ishte i qartë. Unë nuk kisha pse të insistoja më në kërkesën time sepse tashmë e kisha lejen nga ai që t'ia publikoja prononcimet. Por, vetëm pas vdekjes së tij. Për arsye që i di vetëm ai dhe që i mori me vete. Ose thjesht sepse ashtu donte... Teksa sot dëgjoj dhe ridëgjoj zërin e tij në diktafon, më ka mbetur në kujtesë edhe një thënie që Ahmet Osja ma përsëriste shpesh, edhe në prani të ndonjë kolegu të cilën atij ia kishte thënë një koleg dhe shkencëtar i huaj në një ndër udhëtimet e tij të shumta të profesionit jashtë shteti qysh para viteve '90: "Çdo personalitet i çdo fushe, akademik apo profesor qoftë, do të ketë një mangësi në veprimtarinë dhe angazhimet e tij nëse nuk ka miqësi me një gazetar".

Gjergj Fishta u helmua nga Benito Musolini

Po zbardh citimin e drejtpërdrejtë të prof. Ahmet Osja që e kam të ruajtur në diktafon në lidhje me këtë fakt historik ende të panjohur

për publikun shqiptar diku rreth vjeshtës së vitit 2018, prof. Ahmet Osja u prononcuar në mënyrë të plotë për këtë fakt të panjohur historik që unë e dija vetëm me të dëgjuar në Shkodër që prej vitit 2013 nga persona të tjerë dhe që më kishte intriguar kaq shumë. Nuk kisha se ku të gjeja një burim më të sigurtë informacioni sesa te kjo enciklopedi e gjallë në Shkodër.

Osja: "Fishta ka lindur më datë 23 tetor të vitit 1871 dhe ka vdekur më 30 dhjetor 1940 pak pas mesit të natës në 00:46. E marrin dhe e varrosin në varrezat e kishës së Shirqit përtej fshatit Bërdicë. Vetëm pak muaj më pas, në vitin 1941 kanë ardhur dy oficerë italianë me makinë në këto varreza, ia kanë nxjerrë trupin ende të paprishur nga varri dhe ia kanë djegur në Romë. Varrezat e Shirqit ku u varros Fishta janë përmbytur nga Drini dhe unë nuk arrij që të kuptoj sot se ku e kanë gjetur atë varr të paqenë të Fishtës ndonjë shoqatë, e cila bën homazhe goja para varrit të tij!" Gjithnjë sipas prof. Osja: "Kjo ndodhi për arsye se Atë Gjergj Fishta përgjatë vajtje-ardhjeve të tij në Vatikan kishte pasur rast që ta shihte nga afër në Romë, Benito Musolinin. Ndërkohë, gjatë bisedave të lira Fishta është shprehur me shpirti dhe tallje për paraqitjen fizike të Benito Musolinit duke thënë për të ndërmjet të tjerash se 'Ai (Musolini - shënim) e ka kryet rrumbullak si kungull vrake'" (fshat pranë qytetit të Shkodrës - shënimim im A.L.).

Në kushtet e Shkodrës, të një qyteti të njohur edhe ndërkombëtarisht si një qendër e spiunazhit ku kryqëzoheshin e madje vijnë që të kryqëzohen edhe sot shumë interesa të Lindjes dhe të Perëndimit, fjala mori dhenë menjëherë nga hafijet me pagesë dhe ata vullnetarë dhe i shkoi në vesh pikërisht vetë të sharit, liderit fashist italian Benito Musolinit.

Gjatë kësaj bisede, e cila ka disa ndërhyrje të miat për t'u përqendruar vetëm në këtë fakt, për eliminimin fizik të Fishtës, Musolini përdori një metodë dinake e cila vijon që të jetë e suksesshme edhe sot e kësaj dite sidomos nga politika dhe diplomacia nëpërmjet shërbimeve sekrete.

Musolini e ftoi Fishtën në Romë në verën e vitit 1940 për ta dekoruar dhe gjatë audiencës e qerasi sipas zakonit shqiptar me kafe dhe raki. Dhe, kjo rezultoi fatale për këtë të fundit.

Duke filluar nga shtatori i vitit 1940 Atë Gjergj Fishta u sëmur dhe shëndeti i tij mori teposhtë nga dita në ditë. Mjekët

konstatuan përmbajtje arseniku në gjakun e tij ...

Për fat të keq, Fishta nuk e parashikoi këtë veprim djallëzor të liderit fashis dhe t'i shmangej shkuarjes në Romë, duke nxjerrë ndonjë justifikim, p.sh. arsye shëndetësore që përdoret rëndom si justifikim kudo. Vetëm pas helmimit dhe kur i filluan problemet e para shëndetësore, Fishta ishte koshient se nuk do të jetonte gjatë pasi helmimi me veprim të ngadaltë filloi të jepte efektet e parashikuara. Diku rreth nëntor të vitit 1940, gjithnjë sipas Prof. Osja, Fishta u pat shprehur me rrethin e tij të miqve: "E di se nuk e kam të gjatë, unë nuk do të jetoj ma. E di edhe nga më erdhi kjo", derisa edhe u shua në minutat e para pas mesit të natës së datës 30 dhjetorit 1940.

Ndërkohë, në Varrimin e Atë Gjergj Fishtës mori pjesë e gjithë qytetaria shkodrane së bashku me drejtuesit fetarë dhe vendorë të kohës në varrezat e Shirqit. Fjalën e lamtumirës e pat mbajtur Myftia i Shkodrës, çka dëshmon edhe një herë se Fishta ishte një figurë poliedrike përtej religjionit, e cila kishte tejçuar gjithmonë respekt të qytetarët e Shkodrës.

Përse hesht kisha katolike shqiptare?

Duke iu rikthyer kësaj ngjarjeje të panjohur vetvetiu lindin disa pyetje.

– Përse hesht kisha katolike shqiptare për këtë vrasje të pabesë?

Që nga hapja e vendit në vitin 1991 e deri më sot askush nuk ka folur apo shkruar për këtë krim përveç bisedave në kafene edhe ato me gjysmë zëri në Shkodër të atyre pak të moshuarve që kishin dijeni për këtë histori. Kjo për faktin e thjeshtë se me ardhjen e demokracisë e deri në fillim të viteve 2000 kanë qenë gjallë dhe të fortë sa të duash priftërinj françeskanë që prej vitit 1940 kur edhe ndodhi ky krim ishin të rinj. Po kështu, ka pasur dëshmitarë edhe në varrezat e kishës së Shirqit ditën kur dy oficerët italianë të policisë sekrete të Duçës hapën varrin dhe i nxorën trupin ende të patretur të prelatit të lartë fetar, shkrimtarit dhe patriotit të shquar Atë Gjergj Fishta. Pra, një ngjarje e tillë në raport me një personalitet të njohur si Fishta nuk mund të bëhej në fshehtësi dhe pa e marrë vesh njeri.

Por, duke e parë në kënvështrimin se Vatikanin përveçse një qendër e centralizuar e Kishës Katolike është edhe shtet që bën politikën e saj, për mendimin tim ka një shpjegim. Fishta me patriotizmin e tij shkonte përtej qëndrimeve pro italiane, p.sh. kur i ndaluan pëqër disa kohë botimin e revistës "Hylli i dritës". Por, ky i fundit kur ishte puna për çështjen shqiptare ishte në radhë të parë patriot edhe në raport me qëndrimin e shtetit të Vatikanit. Është i ditur fakti se kur u nis në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919, Fishta kishte lënë një takim me Papën në Vatikan gjë që nuk u realizua për shkak të anulimit në momentin e



Foto: Gegë Marubi, 1940

fundit nga Papa. Gjë e cila të çon në arsyetimin se Vatikanin nuk ishte në një linjë me Fishtën për çështjen shqiptare. Aq e vërtetë është kjo sa që edhe sot e kësaj dite Vatikanin nuk e njeh shtetin e Kosovës. Me fjalë të tjera kemi një kontinuitet që prej mëse një shekulli të këtij qëndrimi të shtetit të Vatikanit në raport me çështjen shqiptare. Gjërat duhen thënë ashtu siç kanë qenë dhe akoma më shumë ashtu siç janë. Mjaft më me inferioritet ndaj të huajve në përgjithësi qofshin këta edhe miqtë tanë historikë.

– Përse heshtin historianët shqiptarë për këtë vrasje të bujshme? Apo janë ende të zënë dhe të ndarë në dy kampe dhe po "hulumtojnë" ende që prej vitit 1992 për datën se kur iku gjermani i fundit nga Shkodra, më datë 28 apo 29 nëntor 1944?!

– Përse hesht diplomacia amatore dhe ende foshnjore shqiptare, për të mos thënë më tepër?
– A e dinë historianët dhe diplomatët shqiptarë se Armenia krenohet nëpërmjet diplomacisë së saj profesionale dhe asaj kulturore me vetëm me dy gjëra: Me gjenocidin që Turqia ka bërë në këtë vend në vitin 1913 dhe me këngëtarin e famshëm francez me origjinë armene Charles Aznavur? Pra, vetëm me pak gjëra, por nëpërmjet të cilave armenët ia kanë dalë që të dëgjohej dhe të vlerësohej në kancelaritë e Perëndimit dhe bravo i qoftë për këtë.

Po sa dhjetëra gjenocide kemi pësuar ne si komb gjatë shekujve dhe sa qindra artistë, sportistë dhe dijetarë me famë botërore ka nxjerrë Shqipëria, historia dhe diplomacia e së cilës ose i kanë vënë në pah pjesërisht në bazë të interesave politike të momentit ose i kanë lënë në hije dhe të panjohur si për publikun shqiptar ashtu edhe për atë të huaj?!

Arsyeja e heshtjes për mendimin tim është shumë e thjeshtë. Sepse jemi mësuar historikisht si popull, por akoma më shumë në Shkodër me mentalitetin që të mërmërisim nëpër dhembë të vërtetat dhe të jemi inferiorë dhe frikacakë karshi të huajve, por edhe në raport me skandalet që ndodhin në përgjithësi në këtë vend. Por, në kushtet kur Benito

Musolini u var për këmbësh me gjithë të dashurën nga vetë italianët ashtu, si edhe fashizmi dhe nazizmi u dënuan dhe u penalizuan në Gjyqin e Hagës dhe në tërë botën, kjo heshtje është e pafalshme. Nuk bëhet historia dukë folur me vedi dhe dukë bëllëzuar me nëpër kafene dhe mejhane, "kështu dëgjova por mos i thuaj kujt". Sepse fjalët i merr era, ndërkohë që fjala e shkruar mbetet fakt.

Gjergj Fishtës duhet t'i akordohet titulli i lartë "hero i popullit"

Pasi mëson për këtë krim të mirëfilltë lufte të kryer me gjakftohtësi nga një prej tre krerëve të aleancës fashiste Romë-Berlin-Tokio, Benito Musolinin kundër një prej personaliteteve më të shquara të lettrave shqipe dhe po ashtu një prej patriotëve më të shquar të historisë shqiptare si Atë Gjergj Fishta, mendoj pa më të voglin hezitim se historia e Shqipërisë duhet që të ridimensionohet në raport me vetë personalitetin e tij. Atë Gjergj Fishtës duhet që t'i akordohet menjëherë nga Presidenti i Republikës titulli "Hero i Popullit", pasi përveç meritave të tij të padiskutueshme si shkrimtar dhe patriot i shquar ai është edhe një hero antifashist i vrarë me pabesi në vitin 1940 ose në fillim të Luftës së Dytë Botërore kur fitorja kundër fashizmit dhe nazizmit, të paktën në Europë, as që mund të mendohej dhe vetëm ëndërrrohej. Fitorja mbi fashizmin nga shtete si Anglia e bombarduar dhe Franca që i ra në gjunjë zyrtarisht Gjermanisë dhe pa hyrë fare në luftë nëpërmjet qeverisë tradhtarë dhe kolaboracioniste të asaj kohe aq që mund të mendohej derisa hynë në lojë Rusia dhe ShBA-ja. Me fjalë më të thjeshta, kjo vrasje e pabesë dhe makabër është një dekoratë më shumë për Atë Gjergj Fishtën.

Por, jo vetëm kaq. Unë gjykoj se emri i Atë Gjergj Fishtës i duhet vënë Aeroportit të Rinasit për faktin e thjeshtë se Nënë Tereza, thujse të gjithë veprimtarinë e saj bamirëse nuk e ka zhvilluar në Shqipëri, por në Indi ku edhe vdiq

në vitin 1997. Ndërsa me një krahasim të drejtpërdrejtë, Fishta qëndron shumë më lart se Goxhe Bojaxhi.

Gjithsesi kjo mbetet për t'u parë nga ata institucione të shtetit shqiptar që e kanë për detyrë dhe kompetencë, por unë i mbetem sugjerimeve të mia sepse një figurë e shquar si Atë Gjergj Fishta është akoma më shumë e nderuar pasi vdekja e tij nuk erdhi nga shkaqe natyrore, por me urdhër dhe hjekësi të liderit fashist Benito Musolini. Pra, është një dekoratë e shtuar për të.

E di fare mirë se pasi të publikohet ky fakt i panjohur historik, shumë nga ata sehirxhinjtë e kafeneve të lagjeve, por edhe analistët gjithlogë që na japin mend për gjithçka dhe për çdo gjë për çdo mbrëmje nëpër televizione do të nisnin që të "komentojnë" ... Ata do të jenë të lirë që të vijojnë misionin e tyre të gjithlogut dhe të kontribuojnë me orë të tëra nëse kanë për të shtuar ndonjë informacion plotësues. Por, pas meje ...

GJERGJ FISHTA ËSHTË VARROSUR NË KISHËN FRANÇESKANE NË SHKODËR, VEPRJA E PLOTË QARKULLON LIRSHËM

Nga: Frano KULLI

Mbamendjet, përpos emocioneve që sjellin, sidomos kur ato tregohen bukur përbëjnë një lëndë të çmuar edhe për historinë. Por, kurrsesi ato nuk janë vetë historia. Rëndesa e vlerës së tyre ka një raport proporcional me rëndësinë ngjarjes a personit, i cili ka pasë çukitë në memorjet e bashkëkohësve.

Sa më me peshë publike të ketë qenë personi përreth të cilit vërtiten mbamendjet që tregohen, aq të shumta e të larmishme janë ato. Mirëpo, jo kurdoherë gjithëçka mbahet mend e thuhet si mbamendje është vetë e vërteta. Madje ato, varësisht prej mënyrës sesi

rrefehen e ngjyresës së përshkrimit bisedor, gjithmonë i largohen të vërtetës dhe dashtë e pa dashtë kthehen në legjenda e fillojnë e krijojnë mitet.

Kjo ka ngjarë edhe me At Gjergj Fishtën. Terratisja e figurës dhe emrit të tij e veprës gjithashtu, përreth 50 vjet e ka thelluar hendekun midis të vërtetave përreth tij e miteve të krijuara. Për do vite të mira në fillimvitet '90 të shekullit që shkoi, flitej e përmendej, me rend e pa rend, i mvisheshin atij edhe lavde që s'kishin qenë të tijat e s'kishin pasë lidhje me të, e s'ishte nevoja për to, kurse ajo çka vetë Fishta ishte, vetë shkaku i përmendjes, ajo që e kishte pasë kthyer emrin e tij në një mit qysh në gjalljen e vet, pra vepra e tij letrare e të gjitha gjinive, që ai kishte lëvruar dhe veprimi i tij publik në dobi të Shqipërisë e shqiptarëve, vijonte të ishte prap e struktur në harresë e nuk e kishte kapërcyer ende pragun e dritës. Sikurse nuk ishin rikthyer ende kronikat e shkruara e të botuara në bashkëkohësinë e tij, ata që kishin zënë fill atë çast mbasi ai kishte mbyllë sytë.

Tani kjo është e shkuara, vepra e tij e plotë qarkullon lirshëm, sikurse edhe mbamendjet e bashkëkohësisë janë ribotuar rishmësi e janë në duart e kujtdo që dëshiron t'i ketë ato.

Por, po ndodh prapë rendja kureshtarë mbas thashethemeve edhe, mbasi kanë kaluar 34 vjet prej atëhere dhe, tani nuk më duket se ka arsye të ndodhë. Tani, rrëfimet si mbamendje, që, duke kaluar gojë m' gojë, në formën e thashethemeve, patën ndërtuar dikur mitin, kanë rënë e nuk vlejnë përpara dëshmimeve autentike të risjella e publikuara si atëherë kur kanë ndodhë. Dhe këtë e dëshmojnë të shkruarat e françeskanëve bashkëkohës, të cilat, pa kurrfarë mëdyshje janë ku e ku më të pranueshme si të vërteta historike sesa "biseda me qytetarë të moshuar shkodranë të cilëve u kishin folur për këtë fakt ende të panjohur priftat franceskanë që kanë jetuar deri në vitet 2000". Të cilët paskan pohuar se: "Vetëm pak muaj pas vdekjes së tij në varrezën e kishës së Shirqit në Shkodër, në pranverë të vitit 1941, kanë ardhur me një makinë dy ushtarakë italianë të SIM, e kanë zhvarrosur dhe i kanë marrë trupin ende të patretur me vete. Në vijim, këta të fundit e kanë transportuar në Romë, ku edhe e kanë djegur në bazë të urdhrat të dhënë nga Musolini, të cilit nuk i mjaftoi as eliminimi fizik i Gjergj Fishtës vetëm për një shpottitje, por egoja e tij prej diktatori duhej që të ngopej edhe me veprimin makabër të djegies së eshtrave të tij..."!

Domethënë, Fishta qenka varrosur në Shirq?!

Në të vërtetë, françeskani i parafundit prej "franceskanëve të m'dhaj [mëdhenj]", bashkvëlla në Urdhërin e Shën Françeskut i Fishtës, po dhe ndër

bashkëpunëtorët më të afërt të tij, përkujdestari i vetëm gjuhësor i veprave të Poetit Kombëtar, të cilin ai e çmonte shumë: At' Viktor Volaj, ka vdeku në 1995, me 5 nëntor. (I fundit është At Leon Kabashi, që ka vdekur me 11.11.1998.) Njëri ndër dëshmitarët e frymës së fundit e i varrimit të tij, po se po. Edhe kronikani i gjithë ngjarjes së përmortëshme, gjithashtu. Dhe kronika e tij, gjëndet e shkruar. E, ndoshta në një rast mëdyshjesh e për davaritjen e tyre, kur vjen fjala për saktësime të fakteve të shkruarës, vlen ma shumë se kurrë sentenca latine: "Scripta manent, verba volant" (E shkruara mbetet, fjala fluturon).

Në "At Gjergj Fishta, 1871-1940" përgatitur nga At Benedikt Dema në 1941-shin ai na dëshmon: "N'oren 10 në mbrame shkova edhe njëherë me e pa ...Mbas një ore kthjem në Kuvend, tue lanë në rojë At Antonin Fishten e A. Sebastjan Deden. N'at gjendje të zhgrehunit, mâ fort fjetë se zgjuet kishte vijue deri n'orën 00:35, kur pa pritë e pa kujtue, mbas një trandjeje një çasi të vetem, u shkim prej një sulmit kardjak, tue pasë përbri vllazent e siperpërmendun Dhe derisa ka mbyllë sytë, prej tij nuk kemi asnjë dëshmi tjetër të ndryshme nga kjo. As me gojë as me shkrim".

Ndërsa, At Benedikt Dema, përkujdestari e përgatitësi i librit në fjalë shkruan: "Korteu i gjatë e i madhnueshëm, msa gjithnji kjate qiell e tokë, u leviz për të mbramen herë kah Kisha e Françeskanëve me atë shumicë kunorash e me dekorata, qi dishmuen veprimtarin tanë meritime të Poetit Kombëtar, përpara qerrit të përmortshem të terhjekun prej gjashtë kualsh së pështjellun në pëlhurë të zezë; arken e dekës e mbëlote flamuri kombtar e aj i Italis, qi e bani pjestarin e Akademis së vet. U vendue rishtas në katafalkun e perparshem në mjedis të kishës deri qi mâ vonë Sivlazent e vet e dorruen në fund të Tempullit-n'anën e majtë prej të himit (hyrjes)..."

SI U ZHDIK TRUPI I GJERGJ FISHTËS: NË CEREMONIË E VARRIMIT, ARKIVOLI ISHTE BOSH?!

Nga: Arben LAGRETA

Kur të dielën e parë të janarit të këtij viti i dhashë "send" artikullit investigativ për helmimin e Gjergj Fishtës nga Musolini e mbylla menjëherë laptopin dhe u nisa drejt Rinasit në udhëtimin tim të dytë ndërkontinental. Shkrimi u botua pas tetë ditësh më datë 15 janar kur unë sapo isha kthyer. Megjithatë, kjo periudhë qëllon dhe vijon të jetë shumë e ngarkuar për mua. Nuk jemi si në shtetet e tjera të Europës ku statuti i një reporteri investigativ është i rregulluar me ligj deri në titullin "grand reporter" nga edhe ku




Foto: Gegë Marubi, 1940

mund të kesh më e pakta dy javë kohë për t'u marrë vetëm me një investigim. Ishte Arben Cokaj që më njoftoi rastësisht në Piacë se prej mëse një jave gazetari dhe studiuesi i jetës dhe veprës së Fishtës, Frano Kulli, kishte botuar një artikull interesant për vendin e varrimit të Fishtës. Mirëpo, unë kisha investiguar jo për këtë, por për faktin se ai ishte helmuar nga Benito Musolini dhe se trupin e tij e kishin zhdukur Policia Sekrete e liderit fashist.

Posedoj sinkronin e zërit të prof. Ahmet Osja në intervistën që i mora në vjeshtën e vitit 2018 ose vetëm 18 muaj para se ai të ndërronte jetë. Unë thjesht kam publikuar ato që Osja më ka pohuar. Nëse nuk do të kisha paraqitur sinkronin e zërit të tij mua nuk do të ma botonin shkrimin e datë 15 janar 2024 të "Panorama". Qysh në fund të dhjetorit kontaktova me Aleksandër Cipën, të cilit i shpjegova shkurt se për ca bëhej fjalë. "Ngjarja qenka shumë intriguese Ben, se jam me njerëz e nuk kam kohë që të flasim më gjatë. Nëse e posedon sinkronin e zërit të Ahmet Osja ma nis dhe shkrimin e ke të botuar. Fjalët e tepërta janë fukarallëk", është kjo që më tha Cipa si profesionist i racës së hershme të gazetarisë së shkruar shqiptare, shkurt, saktë dhe qartë. Pra, megjithëse rrënjët i ka nga cepi tjetër i Shqipërisë, Sandri e di fort mirë se kush ishte enciklopedia lëvizëse jo vetëm e Shkodrës por e tërë vendit Ahmet Osja. Çka mjerisht edhe sot e kësaj dite nuk e dinë jo pak intelektualë me tituj shkencorë në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ku Osjes në fakt nuk ia është dhënë nderimi që në të vërtetë meritonte.

Por, mua, në fakt, ajo që më intrigoi për t'i marrë këtë intervistë Ahmet Osjes nuk ishte vendi ku Fishta u varros, por fakti se ai nuk pati një vdekje natyrale, por ngaqë u helmua me pabesi nga lideri fashist Benito Musolini ngaqë ishte shprehur në biseda të lira me njerëz për Duçen se e ka kryet si kungull Vrake. E këtë e kisha edhe nga dy burime të tjera ose 5-7 vjet para bisedave të para me këtë temë me prof.. Ahmet Osja, respektivisht në vitet 2009

dhe 2011. Por, këto ishin dëshmi, të cilave nuk donin tu dilnin për zot publikisht personat të cilëve ua mora. Pra, efektivisht ishin dëshmi të vdekura.

E, diskutimet, debatet apo dhe kundërshtitë duhen përqendruar këtu e jo anash.

Franco e njoh dhe e respektoj, por ai e shmangu debatin që do të duhej bërë në shkrimin e tij të datës 19 janar të "Panorama". Unë nuk kam pretenduar për të gjetur vendin se ku është varrosur Fishta, sepse këtë e dija fort mirë para se ta pohonte aty Frano. Pra, se varrimi i tij u bë në Kishën Françeskane të Shkodrës. Pra, nuk është ky objekti i investigimit tim.

Frano qartësoi për publikun faktin se ku është varrosur Fishta, por kjo nuk e zhvendos as edhe një milimetër thelbin e asaj që unë kam publikuar i pari në shtypin shqiptar në datën 15 janar 2024 të "Panorama" dhe që është i saktë si një e një që bvjnë dy.

Atë që Gjergj Fishta u helmua me pabesi nga Musolini, pasi u spiunua nga fuksat e Shkodrës dhe në vijim edhe nga ata të Vatikanit të cilët ia çuan fjalët e tij shpottitëse në vesh vetë të tallurit, pra kreut fashist Benito Musolini i cili nga ana e tij si diktator nuk pyeste as për kishë e as për xhami, por e bënte ligjin si të donte vetë. Në fakt, ashtu siç kanë bërë historikisht të gjithë diktatorët. Ashtu si edhe e bëri si kriminel gjakftohtë në raport me klerikun e mirë, atdhetarin me kontribute historike dhe shkrimtarin e shquar shqiptar, Atë Gjergj Fishta. Por, jo në publik, por pas mesit të natës. Praktikë kjo e njohur në të gjitha vendet diktatoriale. Por, që nuk pati burrërinë e as këllqe që të mos binte i gjallë në duart e rezistencës italiane kur e kapën dhe e varën për këmbësh njësoj si ndonjë zog kurve së bashku me të dashurën.

Frano, si studiues i Fishtës, do të duhej që të merrej me thelbin e asaj që unë e publikova, nëse do të kishte gjë për të plotësuar apo edhe për kundërshtuar e jo të ndalej në gjëra për të cilat unë nuk kam pretenduar e as që pretendoj që t'i ndryshoj. Frano posedon edhe sinkronin e zërit të

Ahmet Osjas që ia kam nisur me kohë ...

Çfarë ndodhi në mesnatën ndërmjet 30 dhe 31 dhjetorit 1940?

Atë se çfarë ndodhi në mesnatën e paharruar ndërmjet 30 dhe 31 dhjetorit të vitit 1940 ma kishin thënë qysh në vitet 2009 dhe 2011 dy burime të ndryshme në Shkodër, por që nuk donin në asnjë mënyrë që të prononcoheshin publikisht. Që të dy këta burime kishin një të përbashkët edhe më dëshminë e prof. Ahmet Osjes. Atë se një makinë me dy oficerë italianë erdhën dhe e morën kufomën e Fishtës dhe u zhdukën në errësirë. Kurse dy burimet e mia të para që duan të ngelen anonime kanë të përbashkët edhe një detaj tjetër: "Dy oficerë italianë me uniforma dhe spaleta të papame (uniforma e SIM-it, jo e njohur këtu – shënim) erdhën me makinë në 'Rrugën e Gjuhadosit' dhe u futën në rrugicën e Kishës së Murgeshave". Pikërisht aty ky trup i pa jetë i Gjergj Fishtës ishte lënë pasditen e datës 30 dhjetor deri të nesërmen më datë 31 dhjetor 1940 kur do të bëhej edhe varrimi i tij madhështor. Trupi i Atë Gjergj Fishtës u grabit përdhunshëm nga dy oficerë të Shërbimit Sekret – SIM, alias të policisë sekrete private të Musolinit në Kishën e Murgeshave ose siç quhet sot në Kishën e Motrave Stigmatine, pak pas mesnatës ndërmjet 30 dhe 31 dhjetorit 1940.

Tashmë, në bazë edhe të burimeve të tjera plotësuese për të cilat kam pasur mëse mjaftueshëm kohë, një skuadron civilësh prej rreth 10 vetësh i SIM-it kishte mbërritur me avion në Tiranë enkas për të kryer këtë operacion të arsyes shtetërore, në Shkodër. Makina me dy oficerë të SIM-it pasi ka përshkuar "Rrugën e Gjuhadosit" ka hyrë në rrugicën qorre të Kishës së Motrave Stigmatine dhe është ndalur duke bllokuar hyrjen e çdo kalimtarit të vonuar në atë orë të vonë. Civilët të parët dhe në vijim shefat e tyre me spaleta të SIM-it, dy oficerët kanë hyrë brenda në Kishën e

Motrave Stigmatine dhe kanë terrorizuar murgeshat e kësaj kishë. Me ndihmën e skuadronit të civilëve të mbërritur më parë në këtë kishë, në bazë të planit të këtij operacioni sekret duke u thënë atyre: "Këto që do të shihni e dëgjoni këtë natë do t'ia tregoni vetëm varrit. Përndryshe, ju dhe të gjithë pjesëtarët e familjeve tuaja do t'ju shuajmë deri në brezin e tretë si ndëshkim".

Ata e kanë marrë dhe transportuar trupin pa jetë të Gjergj Fishtës me avionin me të cilin erdhën drejt Romës nga edhe ku edhe e kanë zhdukur atje pa lënë gjurmë.

Për pasojë, në ceremoninë e varrimit arkivoli i Atë Gjergj Fishtës ka qenë bosh. Për të kompensuar peshën trupore mund të kenë vendosur brenda ndonjë buratino apo objekt. Pra, po luhej edhe vijimi i zbatimit të urdhrat të SIM, që varrimi duhej të kryhej sikur të mos kishte ndodhur asgjë në sy e faqe të qytetarëve shkodranë. Të gjithë priftërinjtë e Arqipeshkëvnisë së Shkodrës kanë qenë të terrorizuar sepse ajo që kishte ndodhur kishte qarkulluar nën zë. Për pasojë, në orët e para të mëngjesit të datës 31 dhjetor 1940 askush nga drejtuesit e Arqipeshkëvnisë së Shkodrës nuk ka guxuar që të mbajë fjalën e lamtumirës së Atë Gjergj Fishtës. Në këto rrethana të papara fjalimi i lamtumirës së Fishtës i është kaluar me diplomaci Myftisë së Shkodrës. Nuk dihet e nuk është detyra ime që ta di nëse Myftiu i Shkodrës u vu në dijeni nga Arqipeshkëvnia për atë që kishte ndodhur me trupin e Fishtës në kishën e murgeshave. Porse është fakt që fjalimin e mbajti Myftiu i Shkodrës e jo një përfaqësues i Arqipeshkëvnisë, të cilit i takonte në fakt. Sepse me këtë logjikë i bie që të mbahet fjala e lamtumirës për një person nga një kushëri i tretë, kur në fakt do të duhej nga një pjesëtar i familjes. Ndërkohë, masa e paparë e njerëzve të pranishëm në këtë varrim madhështor flet mëse qartë se ai gëzonte një influencë dhe respekt të padiskutueshëm në popull, i cili nga ana e tij nuk dinte asgjë çka kishte ndodhur ashtu si e gjithë Shkodra.

Prof. Mikel Prennushi: "fishta nuk i donte italianet"

Me apartamentin e profesorit të njohur të historisë, Mikel Prennushi, (1929-2009) më ndan vetëm një mur në pallatin nr. 29 të lagjes "Manush Alimani" apo Xhabijej, i cili në vitet '70-'80 konsiderohej nga banorët e kësaj lagjeje si "pallati i aristokratëve" meqë aty banonin funksionarë, intelektualë dhe sportistë të njohur të kohës, si Eljaz Lloja, Elez Lagreta, Rustem Gjata, dr. Agetina Prennushi, bashkëshortja e prof. Mikelit, mjeke e njohur gjinekologe, prof. Manoli, Sabah Bizi, Medin Zhega etj.

Në fillim të vitit 1995, prof. Mikel Prennushi u emërua drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti" të Shkodrës. Në bazë të një thënieje

që vetë Mikeli (ne thirreshim në emër – shënim) na e tregonte shpesh, menjëherë pak ditë pas emërimit, profesor i Gjuhësisë pranë Universitetit të Shkodrës Mina Gero i kishte thënë: “Urime Mikel! Ky është emërimi i vetëm i duhur që Partia Demokratike e Shkodrës ka bërë në këtë qytet tash tre vjet që është në pushtet. Dhe më beso se nuk ta them një fjalë për një tjetër”.

Prof. Mikel Prennushi është nipi i Atë Vincens Prennushit, i cili siç dihet vdiq në tortura pas arrestimit të tij nga regjimi komunist në vitin 1949. Kur binte fjala për Fishtë, Mikeli më thoshte se ai nuk i donte italianët si pushtues, por edhe në përgjithësi priftërinjtë françeskanë nuk i donin italianët e ardhur si pushtues. Gjithsesi nuk është se këtë temë e hapte shpesh porse unë kam qenë prezent kur është folur për të.

Ja perse hesht kisha katolike shqiptare

Duke iu rikthyer kësaj ngjarjeje të panjohur, vetvetiu lindin disa pyetje. Përse hesht kisha katolike shqiptare për këtë vrasje të pabesë?

Pra, një ngjarje e tillë në raport me një personalitet të njohur si Fishta nuk mund të bëhej në fshehtësi dhe pa e marrë vesh njeri. E, në këtë pikë përgjegjësit kryesorë të moszbulimit me ose pa dashje të këtij krimi makabër e kanë studiuesit shkodranë të jetës së Fishtës. Frano sidoqoftë vjen nga Lezha dhe në komunikimet që ka pasur me priftat françeskanë të kohës unë mendoj se ai nuk mund të kishte konfidencën dhe afinitetin që kanë pasur studiuesit shkodranë. Sepse, vërtet Fishta lindi në një zonë të Lezhës, por ama që nga mosha kur mësohet ABC-ja e deri në fund të jetës së tij aktivitetin e kishte në Shkodër.

Duke iu rikthyer pyetjes që kam shtruar për këtë paragraf përgjigjen po ia jap vetë, shkurt, qartë dhe sa më saktë që të jetë e mundur: Gjergj Fishta siç dihet ka qenë prift françeskan. Françeskanët nuk i ka pyetur dhe nuk i pyet njeri në shtetin e centralizuar të Vatikanit. Përkundrazi ata që bëjnë ligjin në Vatikan janë jezuitët. Duke u rikthyer thellë në histori pa shfletuar asnjë faqe, por thjesht nga kultura e përgjithshme që buron nga serioziteti i shkollës shqiptare deri në vitin 1991 kur edhe mora maturën po shpjegoj. Jezuitët janë ata që dogjën bibliotekën e Aleksandrisë në Egjiptin e lashtë, shtet në të cilin ashtu si edhe në Persi (Irani i sotëm – AL) qytetërimi ka hyrë me mijëra vjet para se të vinte në Europën mesjetare. Në kohën kur Egjipti apo Persi bëhej qytetërimi, evropianët nuk dihet nëse ekzistonin dhe nëse ekzistonin ata ishin ende në majë të pemëve dhe nëpër shpella.

Janë ata që bënë kryqëzatat e fëmijëve, janë ata që krijuan inkuizicionin kryesisht në Spanjë dhe janë po ata që dogjën të gjallë Xhordano Brunon.



Foto: Gegë Marubi, 1940

Përfundimisht, për kishën katolike shqiptare “Fishta nuk është yni, por juaji”, pra i Shqipërisë. Pra, Fishta ishte aq patriot saqë para çështjes kombëtare nuk llogariste as Vatikanin, se Italinë fashiste të kohës jo e jo ...

Është i ditur fakti se kur u nis në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919, Fishta kishte lënë një takim me Papën në Vatikan. Në bazë të plotësisht që m'i bëri këtij fakti historik prof. Ksenofon Krisafi pas publikimit të shkrimit tim të parë në datën 15 janar 2024: “Fishta vetë në një intervistë të viteve '30 ka thënë se u nis në Romë bashkë me dy anëtarë të tjerë të delegacionit shqiptar. Thotë se e takoi Papën, por la të kuptohet se kishte mbetur i zhgënjyer prej tij”, gjë e cila të çon në arsyetimin se Vatikanin nuk ishte në një linjë me Fishtën për çështjen shqiptare ...

Sepse jemi mësuar historikisht si popull me mentalitetin që të mërmërisim nëpër dhembë të vërtetat dhe të jemi inferiorë dhe frikacakë karshi të huajve, por edhe në raport me skandalet që ndodhin në përgjithësi në këtë vend. Por, në kushtet kur Benito Musolini u var për këmbësh me gjithë të dashurën nga vetë italianët ashtu si edhe fashizmi dhe nazizmi u dënuan dhe u penalizuan në Gjyqin e Nyrenbergut dhe në tërë botën, kjo heshtje është e pafalshme. Nuk bëhet historia dukë folur me vedi dhe dukë bëlbëzuar me nëpër kafene dhe mejhane “kështu dëgjova por mos i thuaj kujt”. Sepse fjalët i merr era, ndërkohë që fjala e shkruar mbetet fakt.

Kurse tani po marr me “copy-paste” një dëshmi që dha në faqen e Franos në “Facebook”, në lidhje me shkrimin e tij të datës 19 janar 2024, Luigj Shabani, të cilin unë nuk e njoh fare: “Për sqarim. Në kishën françeskanë ka qenë varros Atë Fishta. Vorri i tij ka qenë në hymje te dera e dytë majtas derës kryesore. Kjo derë nuk është asnjëherë, sepse hapsina e derës dhe majtas ka qenë ndertue i ashtëqytun si: dhomë e mbyllun me drasa dikund me sip. 3 me 3 metra katrorë. Me dijenin teme po aty janë rriarrosë dhe eshnat e

Dedë Gjo Lulit fill mbas ceremonisë mortore që ju pat ba në Shkodër dikund me 1922. Në Shkodër para shtëpisë së Ndrek Kaçulinit sot (Muzeu Mrubbi) asht ba edhe fotografia e kortezhit të Dedës. Kjo “dhomë” varr dhe dera ku gjindej kjo për aq sa unë mbaj në mend, kurrë nuk asht hap ndonjiherë kjo derë, deri me prishjen e kishës që u pat ba kinema “Puntori”.

Gabimi i Osjes për vendvarrimin e Fishtës, autogol i qëllimshëm

Prof. Ahmet Osja mbante mend me vit, datë dhe orë shumë e shumë ngjarje të cilat datoni me shekuj përpara e jo më të mos e dinte se Atë Gjergj Fishta u varros në kishën e françeskanëve në Shkodër. Për memorien e tij të jashtëzakonshme mund të dëshmojnë me dhjetëra dhe qindra qytetarë të Shkodrës se ky nuk është një zbulim i imi. Por, meqenëse ai ishte ftuar dhe ftohej ndërmjet të tjerash edhe nga Frano dhe shoqata me emrin e Fishtës, unë jam mëse i bindur se ai nuk ka dasht t'i binte ndesh. Prandaj, edhe nuk preferoi që këtë fakt ta publikonte përse kohë që ishte gjallë. Me fjalë të tjera, Ahmet Osja – në bindjen time mëse të plotë – ka nisur ta tregojë enigmën e panjohur të vdekjes së Atë Gjergj Fishtës duke bërë qëllimisht një autogol me qëllim që në fund ndeshja të mbetej në barazim, pra rremi ...

FISHTËN E NDERON VETËM E VËRTETA

Nga: Ernest MARKU

Nisur nga dy shkrime të botueme në gazetën “Panorama”, të një gazetari që nuk e njoh, me emnin Arben dhe me një mbiemër që të intrigon aq shumë saqë mundesh me aludu se gazetari pretendon me “lagë retë” me investigimet e tija, u detyrova me ndërhy e me pru në kujtesën e lexuesit do të dhana historike. Këto shkrime kanë aq shumë pasaktësi, sa

përbalja me to kishte me kërkun një libër prej qindra faqesh, për të cilin nuk po kam as dëshirë e as ngë. Prandaj, po ndalem vetëm me saktësi disa momente që kanë të bajnë me kalimin në amëshim të At Gjergj Fishtës dhe ngjarjet që pasuen.

Së pari, në lidhje me sëmundjen dhe ndarjen nga jeta të poetit kombëtar, po sjell kujtimet e At Viktor Volajt, atij që nuk iu nda deri sa dha shpirt më 14 tetor, në mbrëmje, e sjellin në Shkodër duke e shtruar drejtpërdrejt në spital, ku pas kurave të para, përmirësohet aq sa për t'iu dhënë shpresë fretërve e familjarëve se po fitonte ndaj sëmundjes. Gjatë muajit nëntor përmirësimet ishin më të dukshme. Më 22 dhjetor, Shkodra mbulohet me borë. Fishta e ka të pamundur që të mos dalë në dritare, që ta shohë atë bardhësi flokësh, e cila pa pushim zbrret prej qiellit, si të ishin qenie të gjalla e po sillnin një mesazh për njerëzimin. Ai e harron sëmundjen dhe faktin se bora është e ftohtë, aq shumë e rrëmben fantazia gati-gati fëmijërore Fratin e Madh dhe Poetin Kombëtar. Të nesërmen e ndjen veten keq, kishte marrë një bronkopneumoni të lehtë, e cila vjen duke u përkeqësuar nga dita në ditë. “Frymëzimi poetik, qi kishte ushqye përherë jetën e tij”, shprehet Volaj [1], “do t'ishte edhe shkaku i një smundjeje që do t'i a këputete fijen e jetës”. Pas tri ditësh, kur vijnë mjekët ta vizitojnë, e gjejnë në një gjendje alarmante, me polmoni bilaterale dhe urdhërojnë transferimin në spital. Fillimisht u duk se po përmirësohej, por më 27 dhjetor mjekët humbin çdo shpresë për ta mbajtur në jetë. E kapin ethe të forta, sa fillon të flasë si në jerm ...

Së dyti, po sjell në vëmendje atë që ndodhi në datat 30 e 31 dhjetor të vitit 1940. Përfshirja e kaq shumë personaliteteve të kohës në këto ngjarje nuk besoj se len vend për me abuzu askush, me kujtime të transmetueme gojarisht: Mëngjesi i 30 dhjetorit e shpërnda anekënd Shqipërisë lajmin e zi. “Në dekë të tij qielli u vra në shenj zie, Shqipëria u përlosh në shenj dhimbje, fretënt e kleri derdhen lot në shenj mjerimi. Ne të rinjve”, shprehet



Gjeçaj [2], “na u dukte sikur kishim mbetë jetima”. Nga mesdita, kur ndërkohë nuk kishin mbërritur të gjitha lajmet, as kishin filluar të vinin delegacionet, njerëzit filluan të mblidheshin grupegrupe, para bashkisë së Shkodrës. Në mënyrë spontane, profesor Karl Gurakuqi doli dhe nisi të mbante një ligjëratë të përmotshme dhe askush nuk lëvizi nga sheshi pa e përfunduar, edhe pse fjalimi ishte mjaft i gjatë.

Pasi bëri një historik të shkurtër, të asaj që ishte dhe asaj që përfaqësonte At Gjergj Fishta, oratori ndër të tjera tha:

“Ky hyll i shkëlqyeshëm u kput prej qiellës shqyptare, ky nier i madh u nda prej mesit t'onë, porse Aj nuk do t'harrohet kurr prej shqyptarvet, Shqypnija do ta kujtojë me mirnjohet, vorri i tij do t'bahet vend peligrinazhi, rinija do ta ket si shembull atdhedashunije, si udhëhjekës n'idealet kombtare; ftyrën e Tij do ta thadroje (skalisë – shënim i EM) n'mermër dhe emnin e Tij do ta përjetsojë n'sheshet e qytetevet me përmendore, për t'ua lanë kujtim brezave t'ardhshëm. Kto ia ka për detyrë Shqipnija, t'cillën Aj e deshti aq fort sa kje gjallë, e per t'cillën e shkruini krejt jetën e vet ...”

Ndërkohë, trupi i At Gjergj Fishtës prehej i shtrirë në Kuvendin Françeskan të Gjuhadrilit, veshur me të zeza, ngritur mbi një “katafalk” të stolisur me kurora të panumërta. Njerëz të shumtë shkonin e vinin, që të pikëlluar në zemër, shikonin për herë të fundit ftyrën e Poetit Kombëtar. Disa kishin hedhur rrënjë aty, në këmbë, me mendjen që u kishte humbur në kujtime të largëta, teksa vështronin ftyrën e ngrirë të Fratit të Madh. Disa të tjerë uleshin në gjunj, duke u lutur për shpirtin e të vdekurit, ndërsa dikush tjetër pëshpëriste: “Asht si gjallë ... s'duket se ka dekë! ... Dam, me dekë ky farë nieri!” Një grup dilte dhe dy-tri grupe të tjera futeshin në kishë, a thue se e gjithë Shqipëria, kishte ardhur për t'i dhënë lamtumirën. Nga spitali, ku kishte dhënë shpirt, pas bekimit të Provincialit të Françeskanëve, At Çiprian Nikës, trupi i Fishtës ishte nisur për të Kisha e Gjuhadrilit, nga rruga e ngushtë “At Shtjefen Gjeçovi”, në sheshin para bashkisë dhe më tej; gjithkund i shoqëruar prej shkodranëve dhe nxënësve të shkollave, që mbushnin dy anët e rrugës ku kalonte kortezhi.

Fill pas arkivolit që mbarte trupin e pajetë të Patër Gjergjit – shprehet Benedikt Dema [3] – vinin ato pak të njohur apo familjarë të tij, që kishin mundur të vinin në kohë. Pas tyre e pas mijëra të tjerëve, vinin me radhë: Senator Gjon Markagjoni, Këshilltari i Shtetit Riza Dani, Nënsekretari i P. F. Sh. Kolë Bib Mirakaj, Dr. Rocco i Zyrës Krahinore të Mëkëmbësisë Mbrojtërore në përfaqësim të S. Melonit, Komandanti i PRESID-it, Prefekti i Shkodrës, Sekretari Federal, Sekretari Krahinuer i Mbaspunës në përfaqësim të Inspektorit Federal të P. N. F.-së, Kolonel Bonfiglio Komandant i Grupit të K. K. Mbretërore, Kuestori, Kryetari i Bashkisë,



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Nora e argjendtë në Baku, do të jetë bartëse në Lojërat Olimpikë

Lëndimi i pamundësoi Nora Gjakovës të garojë për medaljen e artë në Baku të Azerbajxhanit, por ajo u stolisë me medaljen e argjendtë. Trajneri Driton Kuka e ka vlerësuar këtë medalje me shumë vlera dhe ka bërë me dije se xhudistja në fjalë do të jetë bartëse në Lojërat Olimpikë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 SHKURT - Xhudistja Nora Gjakova ka qenë fantastike në Grand Slamin e Xhudos që po mbahet në Baku të Azerbajxhanit. Ajo e ka fituar medaljen e argjendtë. Në fakt, kampionia olimpikë shënoi katër fitore të njëpasnjëshme për ta arritur finalen në kategorinë deri në 57 kilogramë, por në finale ajo nuk do të paraqitet për shkak të një lëndimi dhe në këtë mënyrë është stolitur me medaljen e argjendtë. "Nora Gjakova ishte e

pandalshme deri në finale të Grand Slam Baku 2024, ku për arsye të lëndimit është detyruar ta ndërpresë garën dhe të marrë medaljen e argjendtë. Faleminderit Nora për emocionet!", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.

Pas lëndimit të Nora Gjakovës ka reaguar edhe trajneri Driton Kuka, i cili ka thënë se Nora do të jetë bartëse në Lojëra Olimpikë me pikët e fituara, 700 pikë. "Nora Gjakova e shkëlqyeshme! Prek finalen e madhe. Mposhti georgjiane, mandej Azeren

Toplak e në çerekfinale serben Perishiq. Në gjysmëfinale mposhti holandezen Beurskens në një luftë të fortë, por në të cilën Nora zgjati një muskul pas 2 minuta luftë dhe me shumë mund e ruajti epërsinë. Por ia doli të hyjë në finale ku, për fat të keq, s'do të garoj me sugjerimin e mjekut dhe timin! Medalje me shumë vlerë dhe ajo do të jetë bartëse në Lojëra Olimpikë me pikët e fituara, 700 pikë Olimpikë!", ka deklaruar Kuka. Të shtunën dhe të dielën do të garojnë Laura Fazliu, Dardan Cena dhe Loriana Kuka.



'Nikli' ndali në barazim Ballkanin

Ballkani është dashur të kënaqet me një pikë nga përballja me Feronikelin '74, sikurse edhe Prishtina që luajti baras me Gjilanin. Fitores iu gëzua në Prizren, Drita, që e mposhti skuadrën e Lirisë. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet e tjera të javës së 20-të

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 SHKURT - Skuadra kampione e Superligës, Ballkani, ka dështuar në ndeshjen ndaj Feronikelit, pasi nuk arriti të marrë më shumë se një barazim (2-2). Kjo ndeshje ishte e vlefshme për javën e 20-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Mysafirët shënuan dy gola në pjesën e parë, kurse vendasit një gol. Shënues për "Niklin" ishin Granit Musa dhe Alban Shillova, kurse për suharekasit realizoi Walid Hamidi. Ballkani ishte

skuaer më e mirë në pjesën e dytë, por krejt çka arriti ishte goli i barazimit nga Vesel Limaj (2-2), i cili realizoi në minutën e 50. Pas kësaj ndeshjeje, Ballkani është në vendin e parë me 44 pikë, kurse "Nikli" në vendin e shtatë me 22 pikë.

Në ndeshjen e javës së dytë të sezonit pranveror, Gjilani dhe Prishtina kanë luajtur baras (1-1). Në pjesën e parë skuadrat shkuan në pushim me rezultat 0-0, derisa në pjesën e dytë rastet ishin të shumta dhe të dy skuadrat shënuan nga një gol. Të parët në epërsi kaluan vendasit me anë të



Senad Jarović (51), i cili shënoi nga afërsia për 1-0, ndërsa Ardian Limani (83) vulosi rezultat final 1-1. Pas këtij barazimi, Prishtina është në pozitën e katërt me 30 pikë, ndërsa Gjilani zë vendin e tetë me 20 pikë.

Drita e Gjilanit ka regjistruar fitore shumë të rëndësishme në ndeshjen ndaj Lirisë me rezultat minimal 0-1. Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në Prizren ishte thujtë e barabartë dhe skuadrat shkuan në pushim me

rezultat 0-0. Goli i vetëm në këtë ndeshje erdhi në minutën e 52-të me anë të Blerim Krasniqi, i cili shënoi me kokë për 0-1. Pas kësaj fitoreje Drita renditet në pozitën e tretë me 37 pikë, po aq sa Llapi i dyti me një ndeshje më pak, ndërsa Liria është e fundit me vetëm 9 pikë. Të dielën do të zhvillohen dy ndeshjet e tjera, derisa përballen Malisheva - Fushë-Kosova dhe Llapi - Dukagjini.

SUPERLIGA - Java 20

Ballkani - Feronikeli	2-2
Gjilani - Prishtina	1-1
Liria - Drita	0-1

Të dielën takohen:
13:00 Malisheva - Fushë Kosova
13:00 Llapi - Dukagjini

FFK-ja dhe komuna e Fushë-Kosovës pajtohen për investim në stadiumin e qytetit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 16 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka zhvilluar sot një takim konstruktiv me kryetarin e komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, me të cilin ka biseduar për projektet në fushën e futbollit në këtë komunë. Gjatë diskutimit krerët e dy institucioneve u pajtuan të ndërmarrin një hap të rëndësishëm drejt avancimit të



futbollit dhe përmirësimit të kushteve infrastrukturore në këtë komunë. Në këtë drejtim, Ademi dhe Berisha u pajtuan për investim të përbashkët në ndërtimin e stadiumit të qytetit, në mënyrë që aty të zhvillohen ndeshjet e Albi Mall Superligës. Ky projekt synon të krijojë një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve futbollistike, njëherësh të ofrojë infrastrukturë komode për komunitetin e futbollit në Fushë-Kosovë. "Së shpejti krerët e dy

institucioneve do ta nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit lidhur me këtë projekt, i cili do të krijojë mundësi më të mira për të rinjtë dhe qytetarët e kësaj komune për ta ndjekur dhe praktikuar futbollin. Si pasojë e mungesës së infrastrukturës së nevojshme, KF Fushë-Kosova, që në këtë edicion është pjesë e elitës, ndeshjet si vendëse është detyruar t'i zhvillojë në stadiumin 'Sami Kelmendi' në Lipjan, larg tifozëve vendës", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Red Bull paraqet makinën me të cilën Verstappeni synon titullin e katërt

MILTON KEYNES, 16 SHKURT - Makina Red Bull RB20, me të cilin Max Verstappeni shkon në kërkim të titullit të katërt kampion bote në Formula 1, u paraqit për mediet dhe fansat. Njëvendëshja kampion bote në dy sezonet e fundit synon të

vijojë në këtë rrugë edhe këtë vit. Ajo do të pilotohet nga kampioni holandez dhe meksikani Sergio Perez. Skuadra kampion bote ka nisur kështu fushatën e saj për të dominuar edhe këtë vit, pas skandalit që po kalon me

shefin e saj Christian Horner, i pranishëm në këtë ceremoni. Sa i përket makinës, drejtuesit e kanë përcaktuar RB20 si një evolucion të RB19 që dominoi sezonin e kaluar (fitoi 21 nga 22 gara). Por, në shikim të parë nuk mungojnë risitë,

veçanërisht në nivelin aerodinamik. "Synojmë të jemi sërish dominues në pistë. E dimë që këtë sezon do të jetë më e vështirë, por jemi përgatitur për konkurrencën. Kemi bërë disa përmirësime dhe do të vazhdojmë të bëjmë



përgjatë sezonit", ka thënë Horner.

Behrami: De Laurentis është fajtor për situatën e Napolit

NAPOLI, 16 SHKURT - Ish-mesfushori i Napolit, Valon Behrami, ka fajësuar presidentin e kësaj skuadre, Aurelio De Laurentis, për rënien drastike të Napolit pas fitimit të titullit në sezonin e kaluar. "Partenope" fitoi titullin e parë në Serinë A në më shumë se 30 vjet, por Luciano Spalletti u largua dhe Kim Min-jae u shit te Bayern Muncheni. Pavarësisht se skuadra ka mbetur kryesisht e njëjtë, ata kanë pasur ecuri të dobët, si nën drejtimin e Rudi Garcias, ashtu edhe me Walter Mazzarrin si trajner. "Javë pas jave, gara për hyrje në Ligën e Kampionëve po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar", ka thënë Behrami për "Rai Radio 1 Sport". "Ka pasur konfuzion dhe kaos që nga fillimi i sezonit. Në janar strategjia e transferimeve nuk dukej se varej nga lloji i sistemit që ata duan të zgjedhin. Çdo javë ne shohim një sistem taktik të ndryshëm dhe kjo nuk ndihmon", ka deklaruar ai. Ka gjithashtu tension në prapaskenë me Piotr Zielinski që refuzon të nënshkruajë një



kontratë të re dhe shkon drejt Interit si lojtar i lirë, ndërsa Victor Osimhen ishte në Kupën e Kombeve të Afrikës me Nigerinë që nga fundi i dhjetorit. "Së bashku me ato situata, periudha pas 'Scudetto'-s është trajtuar në një mënyrë shumë kaotike dhe konfuze. Nga presidenti doli një ego e madhe. Ai donte të tregonte herë pas here se ishte vendimtar

në fitimin e titullit. Ai nuk kishte nevojë, sepse sigurisht të gjithë e dimë se personi që vendos paratë meriton kredi", ka deklaruar Behrami, i cili ishte pjesë e skuadrës së Napolit nën drejtimin e Mazzarrin gjatë mandatit të tij të parë në klub, pasi trajneri u kthye pas një dekade për të zëvendësuar Garcian të shkarkuar në tetor 2023.

Minnesota mbron kreun në Perëndim



PORTLAND, 16 SHKURT - Ekipi i Minnesotas mbron vendin e parë në Konferencën e Perëndimit pas

fitores me rezultat 128-91 në fushën e Portlandit. Ndashje e dominuar nga miqtë, ku gjashtë

lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Më i miri në fushë për Minnesotan ishte Edwardsi me 34 pikë. Golden State mposhti në sekondat e fundit pas një ndeshje spektakolare Utah Jazzin me rezultatin 140-137. Klay Thompsoni, që e nisi ndeshjen nga stoli, realizoi 35 pikë për Warriorsin, ndërsa 68 pikët e dyshes Sexton-George mbetën për statistikë. Në Lindje, ekipi i Milwaukee's u mund me rezultat 113-110 nga Memphis, duke humbur disi kontaktin me kreun. Antetokounmpo realizoi 35 pikë e 12 asistime për miqtë, por që s'mjaftuan. Për Memphisin, Jacksoni dhe Williamsi realizuan nga 27 pikë secili.

REZULTATET

Memphis - Milwaukee	113-110
Utah Jazz - Golden State	137-140
Portland - Minnesota	91-128

Griezmanni: Kalimi te Barcelona ishte një gabim

Ylli i Atletico Madridit, Antoine Griezmann, ka bërë deklaratë të fortë për periudhën e tij te Barcelona. Griezmann tashmë është golashënuesi kryesor i klubit të Atletico's. Griezmann iu bashkua Atletico Madridit fillimisht si huazim në vitin

2021, përpara se të përfundonte në një kalim të përhershëm në vitin 2022. Si pjesë e një interviste të gjerë në një ceremoni, Griezmann u pyet për kohën e tij në Barcelonë, nga viti 2019 deri në 2021. "Vendosa të largohem sepse kisha arritur

kufirin tim mendor. Më duhej të largohesha, dhe ju gjithmonë mendoni se jashtë më mirë. Doja të provoja, por pas disa muajsh kuptova se nuk isha aq i lumtur sa në Madrid dhe në Atletico. Isha i zemëruar me veten time dhe më duhej të

punoja shumë dhe të heshtja. U bëra 'i vogël' muajt e parë këtu. Fernando Torres më tha kur u ktheva se nëse lija gjithçka në fushë, tifozët do të më respektonin sërish. Është një gëzim të jem këtu, kam bërë një gabim, siç mund t'i ndodhë

kujtdo, por do të bëj gjithçka që tifozët të jenë krenarë për numrin e tyre 7. Kemi nevojë për ju nga tani deri në fund të sezonit. Faleminderit për dashurinë dhe ne do ta shijojmë atë së bashku!", ka thënë Griezmanni.

SHKURT

Manaj: Tek Interi isha i pamatur, tani punoj shumë në stërvitje

Sulmuesi shqiptar Rey Manaj po kalon një nga momentet më të mira në karrierë. Manaj po shkëlqen te Sivasspori në elitën e futbollit turk. Në 24 ndeshje të luajtura deri më tani mes Superligës dhe Kupës së Turqisë, Manaj ka shënuar plot 16 gola, duke e bërë pikën kyçe te Sivasspori. Në një intervistë të dhënë së fundmi për "TRT" në Turqi, 26-vjeçari nga Lushnja ka treguar arsyen e formës së tij të mirë. Ai thotë që ai po punon shumë në çdo seancë stërvitore, madje tregon për veten e tij kur ishte tek Interi në Itali. "Talenti nuk është asgjë përpara punës. Unë punoj shumë, godas portën dhe provoj goditjet pas çdo seance stërvitore. Kam qenë tek Interi në një moshë shumë të re. Atje isha i pamatur, isha në një klub të madh. Presioni bëri që të mos jepja maksimumin tim. Megjithatë arsyeja se pse po shpërthej tani te Sivasspori është fakti se jam i pjekur dhe mund të nxjerr gjithçka nga vetja. Është kulmi i fuqisë sime. Në vitin e shkuar kishte shumë ekipe nga Turqia që më donin, por ekipi i parë ishte Sivasspori dhe unë i kisha dhënë një fjalë presidentit e nuk mund t'i dilja nga fjala. E di që ka shumë ekipe që më duan, por tani jam i fokusuar vetëm te Sivasspori", është shprehur Manaj.

Mbappe njofton PSG-në se do të largohet në verë

"Mirupafshim Paris!" Merr fund në këtë mënyrë një nga telenovelat më të famshme në botën e futbollit, të paktën seria e parë me Kylian Mbappe që njoftoi zyrtarisht klubin e PSG-së se në fund të këtij sezoni do të largohet. Sulmuesi francez ka njoftuar personalisht sheikun Al Khelaifi, me këtë të fundit që bëri gjithçka që Mbappe të mos largohej, madje duke i ofruar shifra marramendëse. Mbappe do të largohet nga Parisi në fund të këtij sezoni, por jo falas si të gjithë mendonin. Në kontratën që Mbappe kishte firmosur dy vjet më parë ishte përfshirë një klauzolë, nëse nuk do të rinovonte për një tjetër vit, atëherë PSG-ja do të përfitojë 80 milionë euro.

De Rossi: Lukaku ka lindur duke shënuar gola

Trajneri i Romës, Daniele De Rossi, pas barazimit në Ligën e Evropës ndaj Feyenoordit (1-1), ka thënë se është i kënaqur me paraqitjen e skuadrës. "Ishte një ndeshje e vështirë. Ata e kontrollojnë shumë topin, por gjithmonë kërkojnë agresion në raste të tilla. Skuadra përformoi mirë edhe pse pati momente në cilat ne mund të vuanim", ka thënë trajneri italian. De Rossi më pas ka thënë se sulmuesi Romelo Lukaku ka lindur duke shënuar gola. "Po flasim për një nga lojtarët më të fortë në atë rol për momentin. Do të ishte gabim të jemi të vetëkënaqur, por ai ta tregon me punën që bën. Lukaku ka lindur duke shënuar gola. Jam i kënaqur me të, me performancën dhe qëndrimin e tij, si dhe të të tjerëve", ka deklaruar De Rossi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “KASHI” Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 811318642 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “KASHI” D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811318642 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “KASHI” L.L.C, has come to the decision to quit its business: 811318642 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ardit Sopi shpall të pavlefshme dëftesat e Q.K. “11 Marsi”, Prizren.

- Sejdiqe Haruni shpall të pavlefshme diplomën e SHME “Ymer Prizreni”, Prizren.

- Adem Hasani shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Shefket Rashlanin nga Istogu – Prishtinë, shpall të pavlefshme dëftesën e viti –I-, dhe –II-, të shkollës së mesme “Shtjefën Gjeqovi”, Prishtinë.

- Venera Berila shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme “Xhevdet Doda” Prishtinë.

- Ramadan Terpunin nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Nexhmedin Nixha”.

- Albias Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Nexhmedin Nixha”.

- Belinda Begiqi shpall të humbur Diplomën e Bachelorit të Kolegjit “Fama” drejtimi Psikologji.

- Fajtona Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Hysni Zajmi”.

- Rexhep Ternava shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë “Ali Sokoli” ish shkolla e mesme “9 Maji”.

- Egzon Osmani shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 dhe 12 shkolla e mesme e lartë “Arkitekt Sinani”.

- Art Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të shkollës “Hajdar Dushi”.

- Muhamer Bujari shpall të pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Xhynaze Cena shpall të pavlefshme dëftesat e kl BI - IX shfmu “Lidhja e Prizrenit” Prizren.

- Halid Asllani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu “28 Nentori” Brodosan Dragash.

- Halid Asllani shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I Q.K. “11 Marsi” Prizren.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

